

# kronologija e Kosovës

(1974-2017)

## Përmbajtja

Hyrje: Konteksti politik i njoftimit për dialogun e brendshëm për Kosovën .....	3
Kronologjia .....	7
Revolucioni Anti-burokratik: “O Serbi, nga tre pjesë, do bëhesh përsëri e tëra” .....	8
Kronologjia e Luftës së Kosovës .....	11
Proceset para Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPN/ICTY) .....	14
Proceset para gjykatave të vendit .....	15
Podujevë .....	15
Suharekë .....	15
Rahovec .....	16
Tërnje (procesi i shkallës së parë) .....	16
Qyshka (procesi i shkallës së parë, rigjykim) .....	16
Kriza e Kosovës dhe roli i komunitetit ndërkombëtar .....	16
1998 - 2000. ....	16
1999. ....	17
Rënia e Millosheviqit dhe qeveria e parë demokratike e Serbisë .....	24
Dhuna e Marsit .....	25
Negociatat në Vjenë .....	27
“Kosova për atletet” .....	29
Negociatat teknike (Tahiri - Stefanoviq) .....	32
Rezultatet e negociatave të vitit 2011. ....	33
Dialogu i Brukselit .....	34
Konteksti lokal politik si pasojë e dialogut në Bruksel .....	36
Rasti „Dron” .....	37
Gjykata speciale për krime të luftës në Kosovë .....	39
Në vend të konkluzionit .....	40
TABELA E MARRËVESHJEVE NGA DIAOLOGU I BRUKSELIT (2011-2017) .....	41

# Hyrja:

## Konteksti politik i njoftimit për dialogun e brendshëm për Kosovën

... "Prandaj, është e rëndësishme, apo më e rëndësishme se kurrë, që të shihemi në pasqyrë, guximshëm, të shohim në mënyrë të qartë të gjitha mbresat, plagët dhe mangësitë në fytyrën tonë, por edhe të përpiqemi për të shëruar atë që është e mundur, në dëshpërim duke mos hequr dorë nga vetja për shkak të problemeve me të cilat ballafaqohemi."

... Aleksandar Vuçiq, president i Republikës së Serbisë (24 korrik i vitit 2017)<sup>1</sup>

Duket se kjo fjali, si dhe tërë teksti i Presidentit të Republikës, nënkupton të paktën një thirrje verbalizuese për shoqërinë serbe, por edhe për publikun e gjerë (në radhë të parë komunitetin ndërkombëtar) që në qendër të pushtetit politik në Serbi ka një vullnet për të biseduar përfundimisht për Kosovën dhe në bazë të këtij bisedimi të krijohen zgjidhje konkrete dhe afatgjata për Kosovën. Thirrja për dialog brenda shoqërisë serbe, por gjithashtu nga mesi i vitit 2017 takime disi më të shpeshta të zyrtarëve të Beogradit e Prishtinës në kuadër të Dialogut të Brukselit, kësaj here në nivel presidencial, paraqesin një lloj përparimi në krahasim me periudhën prej gushtit të vitit 2015 (Brukseli II) deri në Prill të vitit 2017, kur presidentët e sapozgjedhur të Serbisë dhe Kosovës u bënë Aleksandar Vuçiq përkatësisht Hashim Thaçi.

Megjithatë, siç e vlerësoi Shefi i UNMIK-ut, Zahir Tanin, në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të KB<sup>2</sup> në maj të vitit 2017, situata në Kosovë është në përgjithësi e qëndrueshme, por niveli i besimit mes dy komuniteteve është në rënie për shkak të deklaratave të papërgjegjshme nga politikanët dhe diplomatët.

Pikërisht deklaratat e politikanëve, bile të ministrave në Qeverinë e Serbisë, si dhe politika e mosndëshkimit për shkelësit që kërcënojnë ngjarjet që kërkojnë bashkëpunimin e dy shoqërive, dhe që ndodhën muajt e fundit në Serbi, janë tregues që - megjithëse egziston thirrja për dialog, si dhe bisedimet në Bruksel - baza e politikës zyrtare të Serbisë ndaj Kosovës është ende e përshtatur në masën e mbrojtjes së politikës së përgjakshme të regjimit të Slobodan Millosheviqit. Çmimin e një politike të tillë e paguajnë ende qytetarët dhe qytetaret e Serbisë dhe Kosovës, pavarësisht nga kombësia e tyre. Kjo dëshmohet nga deklaratat e fundit e Nela Kuburoviqit, Ministres serbe të Drejtësisë, Aleksandar Vulinit, Ministrin të Mbrojtjes, si dhe Ivica Daçiq, Ministrin të Punëve të Jashtme.

Ministrja e Drejtësisë e Serbisë, Nela Kuburoviq, më 16 maj të vitit 2017, në Këshillin e Sigurimit të KB-së<sup>3</sup>, vuri në dukje nevojën që Prishtina të përmbushë sa më shpejt detyrimet e saja për çështjen e Asociacionit të Komunave serbe (AKS), tërhoqi vëmendjen për veprimet dhe deklaratat e William Walkerit, si dhe

1 Përse është e rëndësishme për ne dialogun e brendshëm për Kosovën, Blic, 24.07.2017: <http://bit.ly/2x1crUb>;

2 Kuburoviq në KB: Prishtina ende përdor dialogun për kërcënim, N1 Info, 16.05.2017: <http://bit.ly/2jmaX1G>;

3 Njësoj;

refuzimin e Francës për të ekstraduar Ramush Haradinajn në Serbi. Në të njëjtën mbledhje, siç vëren Istiner<sup>4</sup>, në të cilën sipas Ligjit për Qeverinë duhej të merrte pjesë Kryeministri (në atë kohë në Kinë) ose Zëvendëskryeministri i parë dhe Ministri i Jashtëm, Ivica Dačić, Ministria e Drejtësisë deklaroi si në vijim:

· *"Do të kujtoj, në KeM gjithçka filloi nga gënjeshtret e dala nga njerëzit si William Walker, i cili sot as nuk i fsheh aspak  
· ambicjet dhe projektet e veta të mëdha shqiptare, dhe dihet që i kundërshtohet Gjykatës Speciale, e cila duhet të ndjekë  
· penalisht krimet e kryera nga e ashtuquajtura "Ushtri Çlirimtare e Kosovës" (UÇK). (...) Vendimi i paligjshëm për agresionin  
· kundër RFJ-së pasoi në radhë të parë në bazë të raportit të William Walkerit, edhe pse në KeM nuk kishte asnjë katastrofë  
· humanitare apo persekutim të shqiptarëve të Kosovës në vitet 1998-1999"*<sup>5</sup>

Pastaj, dy ditë pas publikimit të tekstit të Presidentit të Republikës, çështja bëhet e qartë kur lexohet deklarata e ministrit Vulin nga 26 korriku:

· *"Si gjithmonë, kur Vuçiq ngre çështje me rëndësi dhe peshë thelbësore për serbët dhe shqiptarët, del se nuk ka bashkëbi-  
· sedues të sinqertë midis shqiptarëve. Deklaratat e Ramës dhe Paçollit duhet të bëjnë të pamundur dialogun, ta dëmtojnë  
· Vuçiqin dhe ta parandalojnë atë që të bashkojë serbët rreth KeM."*<sup>6</sup>

Pas kësaj, më 16 gusht të këtij viti, kur Këshilli i Sigurimit i KB-së shqyrtoi përsëri një periudhë tre mujore mbi punën e misionit të UNMIK-ut në Kosovë, Ivica Dačić deklaroi si vijon:

· *"Serbët kanë jetuar në Kosovë për shekuj, kjo konfirmohet nga kishat, katër prej të cilave janë nën mbrojtjen e UNESCO-s.  
· Nuk është e drejtë të qeshni zonja Çitaku, tregoni një monument tuajin nga ajo periudhë, që të qesh edhe unë... A mendoni  
· se kjo nuk duhet të përmendet më dhe se është legjitimuar me atë që ndodhi? A do të përmend dikush nevojën e kthimit  
· të serbëve? Statistika është dëshpëruese. Nëse ka patur gjenocid, kjo do të thotë që tani duhet të ketë më pak shqiptarë"*

Ai tha se sipas regjistrimit të popullsisë nga koha e RSFJ-së në Prishtinë, kishte 43.885 serbë, dhe sipas regjistrimit të vitit 2011, kanë mbetur vetëm 430:

· *"Është 100 herë më pak për 30 vjet. A është spastrimi etnik dhe gjenocidi kundër shqiptarëve apo serbëve?" Në Ferizaj tani ka  
· 32 serbë, 600 herë më pak se më parë, në Podujevë ka patur 2.242 dhe sot 12, që është 200 herë më pak. Në Prizren, ku kam  
· lindur, më parë ishin 11.650, më 2011 - 231, dhe sot vetëm 27. Komenti është i tepërt dhe prandaj ju lutem të mos përdorni  
· përsëri ato fakte të rreme se jeni viktimat të spastrimit etnik. Kush është fajtor për krimet duhet të përgjigjet, por viktimat  
· më të mëdha janë serbët."*<sup>7</sup>

Pra, egziston thirrja për dialog të brendshëm, por në deklaratat e tyre zyrtarët serbë pretendojnë dhe përsërisin tre tezat e mëposhtme:

Nuk pati dhunë ndaj shqiptarëve të Kosovës gjatë periudhës 1998-1999, prandaj nuk kishte arsye për ndërhyrjen e NATO-s;

Anëtarët e popullit serb janë viktimat më të mëdha të konfliktit në Kosovë;

Pala shqiptare është ajo që pengon dialogun, ndërsa pala serbe është "e përkushtuar" për dialog;

Pikërisht për shkak të këtyre tre pikave neuralgjike të Beogradit zyrtar ndaj Kosovës, politika e mohimit të krimeve të luftës dhe fushatave të spastrimit etnik ndaj shqiptarëve të Kosovës është baza e çdo politike të deritanishme të Beogradit ndaj Kosovës dhe ajo po vazhdon.

Megjithatë, për të kujtuar si zyrtarët shtetërorë ashtu edhe publikun e gjerë, ne duam të paraqesim kronologjinë e viteve të para luftës, të luftës dhe të pasluftës, me referim të veçantë në negociatat ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Të kujtojmë, në janar të vitit 2015., Nisma i dërgoi Qeverisë së Serbisë raportin e OSBE-së (në mandatin e të cilës mbështetet ministria Kuburoviq) "Siç është parë, ashtu është thënë", në të cilin u përshkrua detajisht fushata e

4 Nuk kishte persekutim të Shqiptarëve të Kosovës, as nuk kishte katastrofë humanitare, Istiner, 16.05.2017: <http://bit.ly/2xZ8vAX>;

5 Njësoj: <http://bit.ly/2xZ8vAX>;

6 Vulin: Ndërmjet shqiptarëve nuk ka bashkëbisedues të sinqertë, RTS, 26.07. 2017: <http://bit.ly/2y8tVfI>;

7 Ministri Dačić në mbledhjen e KS të KB-së për punën e UNMIK-ut, Sajti i Ministrisë së Punëve të Jashtme, 16.08. 2017: <http://bit.ly/2eVud0Z>;

spastrimit etnik ndaj shqiptarëve të Kosovës, si dhe gjithë konflikti ndërmjet forcave të Ushtrisë së Jugosllavisë, policisë serbe dhe njërive paraushtarake kundër forcave të UÇK-së.<sup>8</sup> Gjithashtu, pas ndërprerjes së vazhdueshme të festivalit „Mirëdita, dobar dan!“ në qershor të këtij viti, në një letër të hapur, ne e ftuam Presidentin e Republikës, ndër të tjera, të qëndrojë në anën e atyre që me vite promovojnë vlerat e pajtimit dhe bashkëpunimit, dhe se nevojitet një dialog më i gjerë social, por pika e tubimit duhet të jetë mesazhi: "Është turp të urresh!".<sup>9</sup>

Reagimet e opozitës, përfaqësuesve të bashkësive fetare, Akademisë së Shkencave të Serbisë dhe organizatave të tjera joqeveritare për hapjen e dialogut për Kosovën, kryesisht ishin të rezervuara ose me qëndrim negativ. Sasha Janković, kryetar i Lëvizjes së Qytetare të Lirë (LQL), deklaroi se për të thirrja për një dialog të brendshëm është fshehtë prapa popullit<sup>10</sup>. Dragoljub Miqunović, përpara Partisë Demokratike, në një intervistë për "Vreme", tha se edhe pse thirrjen për dialog nuk e pranon, sepse ajo është e vendosur në gënjeshtër, prapëseprapë konsideron se është e panevojshme për të refuzuar zyrtarisht thirrjen për shkak se ajo do të keqpërdorej. Ai gjithashtu theksoi se me kusht mbështet dialogun për Kosovën: që për opozitën të hapen mediat, dhe për t'u kthyer dialogu në institucionet demokratike.<sup>11</sup> Sasha Radulović (Dosta je bilo – Mjaft ishte) paraqiti planin e tij për Kosovën në një artikull të tij për "Nedeljnik" në të cilin ka vlerësuar se dialogu ka për qëllim që Kosovën ta nxjerr nga paraambula e Kushtetutës, kur ai është për një konferencë të re ndërkombëtare të fuqive të mëdha që do të dilnin me një marrëveshje të re ndërkombëtare për të zëvendësuar Rezolutën 1244.<sup>12</sup> Partitë e tjera opozitare shprehën dyshimin në lidhje me dialogun (Nova stranka – Partia e re, SDS – PSD e Boris Tadiqit, Vuk Jeremiq) ose e karakterizuan dialogun si tradhëti (Dveri dhe Srpska Radikalna stranka – Partia Radikale Serbe). Megjithatë, partia e vetme që propozoi kornizën për dialog është LDP (PDL) që prezantoi Platformën për Kosovën më 2 gusht të këtij viti.<sup>13</sup> Udhëheqësi i kësaj partie, Çedomir Jovanović, në intervistën për "Večernje Novosti" të 18 shtatorit, njoftoi mundësinë e bashkëpunimit me Partinë Demokratike rreth Platformës për Kosovën.<sup>14</sup>

Nga ana tjetër, vetëm pak ditë pas tekstit të Presidentit të Republikës, Vladimir Kostiq, kryetari i ASSHA-së, tha për Blic se "dialogu mbi Kosovën dhe biseda, e jo lufta, janë e vetmja rrugë nëpër të cilën duhet të ecet për të kapërcyer keqkuptimet shumëshekullore të dy popujve".

Ai shtoi gjithashtu se "ASSHA do të jetë e nderuar që të marrë pjesë në përcaktimin e të ardhmes së popullit të saj, dhe se dialogu për KeM është pikërisht çështja mbi të cilën thyhet ajo, dhe prandaj kanë detyrim për të shprehur pikëpamjet e tyre". Është interesante se Kostiq në të njëjtën deklaratë rrethoi qëndrimin e vet dhe qëndrimin e ASSHA, se fjalët e tij janë pikëpamjet e tija personale.<sup>15</sup>

Patriarku i KOS-it Irinej tha më 17 shtator se beson se për çështjen e Kosovës, Presidenti i Serbisë Aleksandar Vučić mendon njësoj si populli serb dhe Kisha, dhe se ka besim te Rusia, se do të ndihmojë Serbinë të ruajë atë që ka qënë gjithmonë serbe.<sup>16</sup> Zëvendëskryeministrja e Qeverisë së Serbisë Zorana Mihajloviq pret që Kisha Ortodokse Serbe të jetë një partner i mirë në dialogun e brendshëm mbi Kosovën dhe të mos ushtrojë presion mbi Presidentin e Serbisë Aleksandar Vučić para fillimit të bisedimeve mbi Kosovën. "Serbia ka nevojë për një politikë të re që synon të përmirësojë jetën e bashkatdhetarëve tanë në Kosovë, politikën e mbrojtjes së trashëgimisë tonë kulturore dhe fetare, ruajtjen e interesave ekonomike dhe pajtimin me popullin shqiptar", tha Mihajloviq në një deklaratë të njëjtën ditë, duke iu përgjigjur deklaratës së Patriarkut Irinej.<sup>17</sup> Të nesërmen reagoi Peshkopi i Baçkës Irinej: "Mihajloviq në fakt e mohon dhe me qëllim ka maskuar thirrjen e z. Vučićit në një dialog vërtet të domosdoshëm për të ardhmen e Serbisë dhe çdo qytetari të Serbisë në krahinën jugore serbe."<sup>18</sup>

8 Nisma i dërgoi Qeverisë së Serbisë raportin e OSBE-së, Sajti i Nismës së të rinjve për të drejtat e njeriut:

<http://bit.ly/154IMbQ>;

9 Letra e hapur Presidentit të Republikës së Serbisë Aleksandar Vučićit, Sajti i Nismës së të rinjve për të drejtat e njeriut, 02.06.2017: <http://bit.ly/2vUFCoG>;

10 Janković për dialogun: Vučić fshehet si frikacak pas popullit, N1 Info (26.07.2017): <http://bit.ly/2fgPICH>;

11 Dragoljub Miqunović, Ka dialog në gënjeshtër, VREME (Nr. 1387/ 2.08.2017): <http://bit.ly/2xjJEKz>;

12 Sasha Radulović, Plani im për Kosovën, Nedeljnik ( 31.08.2017): <http://bit.ly/2hdjLBR>;

13 PLD, Platforma për Kosovën, (2.08.2017): <http://bit.ly/2ybcILB>;

14 Çedomir Jovanović, për Jankovićin janë më të afërt ata që kanë djegur ambasadat, Večernje Novosti (18.09.2017): <http://bit.ly/2xbpZwZ>;

15 Kostiq shprehu pikëpamjet e tij, jo pikëpamjet e ASSHA-së, Blic (29.07.2017): <http://bit.ly/2xjKiro>;

16 Irinej: Besoj se Vučić për Kosovën mendon si populli dhe Kisha, N1 Info (17.09.2017): <http://bit.ly/2fgyhgo>;

17 Mihajloviq: KOS të mos bëjë presion mbi Vučićin, N1 Info (17.09.2017): <http://bit.ly/2xjAOrf>;

18 Peshkopi Irinej: Të mendojmë me kokën tonë dhe nuk do të heshtim për KeM, Dnevnik (19.09.2017):

<http://bit.ly/2hfjChl>;

Për çështjen e Kosovës, Kryeministrja Brnabiq u shpreh më 27 gusht, pothuajse duke u betuar në Kushtetutën e tanishme, duke thënë se Serbia kurrë nuk do ta njohë pavarësinë e Kosovës. Megjithatë, në të njëjtën deklaratë shtoi: "Serbia ka bërë shumë për të zbatuar atë që është rënë dakord gjatë dialogut, ndërsa Prishtina duhet të fillojë të punojë në pikat më të rëndësishme të marrëveshjes, para së gjithash ndaj pozitës së komunitetit serb."<sup>19</sup> Menjëherë pas konferencës së jashtëzakonshme për shtyp të presidentit Vuçiq në mbrëmjen e 12 shtatorit, me rastin e formimit të Qeverisë së re të Kosovës, në të cilën Presidenti i Republikës, ndërmjet të tjerash, tha se dialogu do të institucionalizohet në tetor, por se "do të respektohet Kushtetuta por se nuk janë luftëtarë për interesat e Serbisë vetëm ata që respektojnë Kushtetutën dhe fund!" - Kryeministrja Brnabiq më 18 shtator deklaroi si në vijim:

*· · · "Kontributi i Qeverisë së Serbisë në dialogun e brendshëm për Kosovën dhe Metohinë do të jetë i dukshëm nëpërmjet krijimit  
· · · të një grupi punues për mbështetjen logjistike të Presidentit të Republikës së Serbisë Aleksandar Vuçiq dhe të gjithë qyteta-  
· · · rëve që duan të marrin pjesë në atë dialog. Ky do të jetë dialogu i një rrethi më të gjerë njerëzish në Serbi, dhe unë, si Kryetare  
· · · e Qeverisë, nuk do të them se si duhet të bëhet kjo apo ajo, por unë do të dëgjoj të gjitha palët, pozitën dhe opozitën, Kishën  
· · · dhe organizatat joqeveritare, sepse ky është dialogu që kryhet nga Presidenti i shtetit". Kështu iu përgjigj Kryeministrja  
· · · Ana Brnabiq pyetjes së RTV-së më 18 shtator, se cili do të jetë kontributi i saj në dialogun e brendshëm mbi Kosovën dhe a  
· · · mendon ajo se Kosova duhet të ketë karrike në Kombet e Bashkuara.<sup>20</sup>*

Me shpresën të qëllimi i sinqertë që të nisët dialogu për çështjen e Kosovës, ne e konsiderojmë të nevojshme të paraqesim të gjitha ngjarjet dhe proceset e rëndësishme që kanë ndodhur në territorin e Kosovës ose janë (si raste të caktuara të negociatave) të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes së Kosovës nga viti 1974 deri në shkrimin e këtij dokumenti, domethënë deri në vitin 2017.

19 Brnabiq: Serbia kurrë nuk do të njohë Kosovën, N1 Info (27.08.2017): <http://bit.ly/2xetkJo>;

20 Brnabiq: Nuk do të them unë se çfarë duhet të bëhet me Kosovën, RTV (18.09.2017): <http://bit.ly/2xce0PX>;

# Kronologjia

**1974:** Edhe pse u përcaktuan si krahina autonome të Serbisë, dhe jo si republika të plota, Kosova dhe Vojvodina, sipas Kushtetutës së vitit 1974, u bënë elemente përbërëse të federatës. Përfaqësuesit e tyre, pra, kishin një anëtarësim të posaçëm në presidencën kolektive të rradhës të shtetit që mori pushtetin pas vdekjes së Titos. Secila krahinë autonome kishte bankën e saj qendrore dhe një sistem të veçantë policor, shkollor dhe gjyqësor, një asamble krahinore, si dhe përfaqësues në Kuvendin e RS-së të Serbisë, dhe më e rëndësishmja në atë kohë, edhe Partinë Komuniste të krahinës, në rastin e Kosovës Lidhjen e Komunistëve të Kosovës.<sup>21</sup>

**1981:** Pas vdekjes së Josip Broz Titos, filluan kërkesat e shqiptarëve të Kosovës për statusin e plotë të Republikës (e cila përfshinte të drejtën e shkëputjes). Që nga muaji mars i të njëjtit vit, me rebelimin e studentëve të Universitetit të Prishtinës në mbarë krahinën, u bënë protesta masive, por demonstratat u hasën në reagim të ashpër në fillim të autoriteteve të krahinës, dhe pastaj në përgjigje të armatosur të organeve të sigurisë të republikës dhe federale. Në krahinë u vendosën njësitë e ushtrisë federale, dhe kësaj i parapriu shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme. Pasi trazirat zgjatën shtatë vitet e ardhshme, sipas të dhënave zyrtare, rreth 7000 shqiptarë u dënuan me dënime më të shkurtra me burg, ndërsa 1750 u dënuan me dënime më të gjata, deri në 15 vjet, në lidhje me veprimtarinë nacionaliste.<sup>22</sup>

**1985:** Më 1 maj, ndodhi rasti i famshëm i Gjorgje Martinoviçit, një punonjësi të Shtëpisë së APJ-së në Gjilan, që sipas versionit zyrtar të autoriteteve u lëndua vetë në fushë. Megjithatë, përkundër pohimeve gazetave lokale, sidomos Politika e Beogradit, udhëhoqën fushatën e akuzimeve se Martinoviç është ngulur në hu nga të paktën tre persona me kombësi shqiptare.<sup>23</sup>

Dyshimet në versionin zyrtar të ngjarjes kanë shkaktuar që rasti i Gjorgje Martinoviçit të bëhet nga galvanizuesit e konfuzionit të besimit multi-etnik në Kosovë.

**1986:** Memorandumi, ky projekt i papërfunduar i një dokumenti akademik, preku çështje të ndryshme, ndër të cilat ishin komplotet e supozuara kundër Serbisë, dhe që i udhëhoqën Sllovenia dhe Kroacia. Një nacionalizëm i tillë shkatërrues për unitetin e shtetit konsiderohej si mëkat në RSFJ, dhe u sulmua ashpër anëmbanë vendit, bile në fillim edhe nga Slllobodan Millosheviç. Pasojat, megjithatë, ishin eksplozive, në asnjë vend kaq shumë sa në Kosovë, nëse nuk do të ndalin dhe kthejnë procesin e "shqiptarizimit" të krahinës.<sup>24</sup>

**1987:** Data kritike për nacionalizmin serb dhe të ardhmen e Kosovës ishte 24 prill i vitit 1987. Slllobodan Millosheviç, në atë kohë një figurë e shquar në Partinë Komuniste Serbe, Lidhjen e Komunistëve të Serbisë, vajti në Kosovë për dialog me serbët lokalë lidhur me ankesat e tyre. Derisa ishte në takim me përfaqësuesit e tyre në Fushë Kosovë, një grup i madh personash që shfaqti mbështetje ndaj kërkesave serbe u shtyp nga policia lokale që përdorte shkopinj. Masa dha rezistencë, dhe pastaj Millosheviç doli për t'iu drejtuar të mbledhurve. Ai e bëri veten hero të serbëve të Kosovës, duke u thënë atyre para kamerave televizive: "Askush nuk guxon t'ju rrahë". Në atë kohë, kërkesat e tyre kontradiktore nacionaliste i pranoi

<sup>21</sup> Analiza e OSBE Misionit Verifikues në Kosovë: Siç është parë, ashtu është thënë, OSBE (ODIHR), Edicioni Dokumenta-Fondi për të drejtën humanitare, faq. 3, 1999: <http://bit.ly/2x0h6Ec>;

<sup>22</sup> Njësoj, faq. 4: <http://bit.ly/2x0h6Ec>;

<sup>23</sup> Dragan Vlahoviç, Martir nga Kosmeti, Glas javnosti, 8.09.2000: <http://bit.ly/2y5SjOW>;

<sup>24</sup> Analiza e OSBE Misionit Verifikues të Kosovës: Siç është parë, ashtu është thënë, OSBE (ODIHR), Edicioni Dokumenta-Fondi për të drejtën humanitare, faq. 4, 1999: <http://bit.ly/2x0h6Ec>;

si të vetat. Deri në fund të vitit 1987, Millosheviq mori kontrollin edhe të partisë, edhe të RS-së të Serbisë pas Mbledhjes së Tetë të KQ të LK-së të Serbisë, duke mposhtur rrymën e Ivan Stamboliqit.<sup>25</sup>

## Revolucioni anti-burokratik: "O Serbi, nga tre pjesë, do bëhesh përsëri e tëra "

### 1988 - 1989.

Trazirat politike dhe konfliktet në kreun politik krijuan kushtet për ngritjen e Millosheviqit dhe protesta të gjera të popullit në Serbi. Gjatë viteve 1988 dhe 1989, protestat arritën kulmin në "revolucionin anti-burokratik", një sërë mitingjesh dhe demonstratash të punëtorëve industrialë, serbëve nga Kosova, aleatëve të tyre dhe grupeve të tjera, me përkrahjen e madhe të Millosheviqit, si dhe protestave të kthyer të shqiptarëve nga Kosova. Ngjarjet u quajtën "revolucionin anti-burokratik", pak ironike, për shkak të rrjedhës dramatike të demonstratave dhe pasojave të tyre të rëndësishme politike. Një sërë zyrtarësh jugosllavë të nivelit të lartë dhe qeverive rajonale, të cilët pjesëmarrësit e protesteve i quajtën "burokratë" të protestuesve, ranë jo me famë nga pushteti në mes të rebelimit të popullit, që përfundoi me dhunë dhe represion. Vala e protestës dhe ngjarjet e ardhshme shënojnë episodin e rëndësishëm të konfliktit jugosllav pas Titos.<sup>26</sup>

### 1988.

**17 nëntor:** Në mbledhjen e Komitetit Krahinor të LK të Kosovës, u shkarkuan Kaqusha Jashari, Kryetare e Kryesisë së LK të Kosovës, dhe u shkarkua nga anëtarësimi Azem Vllasi.

**17-21 nëntor:** Demonstratat më të mëdha të shqiptarëve pas vitit 1981 për shkak të shkarkimit të Vllasit dhe Jasharit.

**19 nëntor:** Në Beograd, në Ushqe, një milion njerëz të pranishëm në mitingun e mbështetjes për Jugosllavinë, që në të vërtetë ishte një konfirmim i mbështetjes së popullit serb udhëheqjes së Serbisë, së pari Sllobodan Millosheviqit. Në fjalimin e tij, ai njoftoi shkarkimin e disa njerëzve, dhe si prioritet përmendi vendosjen e paqes dhe ndalimin e "terrorit" në Kosovë me qëllim të bashkimit të Serbisë.

Në mbështetje të zyrtarëve të shkarkuar të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës (Azem Vllasit dhe Kaqusha Jasharit) dhe ruajtjes së autonomisë-SAP Kosovo, më 20 shkurt të vitit 1989 rreth 200 minatorë mbetën në gropën Sheshi i Vjetër në minierën e Trepçës. Minatorët kërkuan edhe shkarkimin e -Rahman Morinës (Rahman Morina), kryetarit të sapozgjedhur të Komitetit Krahinor, si dhe -Ali Shukrisë (Ali Shukriu). Që më 21 shkurt greva e përgjithshme ishte në të gjithë krahinën. Dy ditë më vonë, Kuvendi i RS-së të Serbisë sjell ndryshime në Kushtetutë, me të cilat rikthen juridiksionin mbi gjyqësorin, policinë, mbrojtjen popullore dhe çështjet e jashtme të krahinave (edhe pse amendamentet duhet të miratohen nga kuvendet krahinore). Në Kosovë, studentët dhe një numër i madh i profesorëve bashkohen me punëtorët në grevën e përgjithshme, ndërsa në të njëjtën kohë Presidenca e RSFJ-së dërgon policinë federale si përforcim.

### 1989.

Pas demonstratave shqiptare në vitin 1982, serbët e Kosovës (të udhëhequr nga Kosta Bullatoviq, Miroslav Sholeviq dhe të tjerët) kanë filluar të rebelohen kundër "presioneve të pabesa nga shteti", ndërsa qendër e lëvizjes u bë qyteti Fushë Kosova, ish-koloni e Serbisë. Në të njëjtën kohë, në Serbi nis fushata anti-shqiptare, tema qendrore e të cilës është "gjenocidi" kundër serbëve në Kosovë, si dhe emigrimin e serbëve e tregon si një plan të spastrimit etnik të kryer nga qeveria e krahinës. Në prill të vitit 1982, 21 priftërinj ortodoks serb, duke përfshirë edhe disa peshkopë në të ardhmen (Atanasije Jevtiq, Irinej Bulloviq, Amfilohije Radoviq), u dërgojnë organeve më të larta të kishës dhe shtetit „apel për mbrojtjen e

<sup>25</sup> Njësoj, faq. 4-5: <http://bit.ly/2x0h6Ec>;

<sup>26</sup> Nebojsa Vladislavjeviq, Revolucionin anti-burokratik dhe punëtorët, Projekti i CZKD-it (QPDK) "Të emërohet luftë ", Tryeza e rumbëllakët "Punëtorët dhe nacionalizmi", faq. 1, 27.02.2013. E disponueshme në: <http://bit.ly/2x1SeNI>;



popullatës serbe dhe faltoreve të saj të shenjta në Kosovë dhe Metohi", që flet për "gjenocidin e planifikuar kundër popullit serb" dhe aktualizoi besëlidhjen e Kosovës. Në vitin 1983, gazeta e Kishës Orthodhoksia publikon feltonin e Atanasije Jevtiqit "nga Kosova në Jadovno", i cili përshkruan rastet e "përdhunimeve brutale dhe shtazore të grave serbe, vajzave, grave të moshuara dhe murgeshave nga Arbanasët e shfrenuar", ndërsa vuajtjet e serbëve në Kosovë, krahasohen me vuajtjet në NDH (SHPK). Duke shkruajtur për shqiptarët, autorët e kishës zakonisht theksojnë mizoritë e tyre, duke i përshkruar ata si përdhunues, banditë dhe dhunues.<sup>27</sup>

Nga fundi i protestave të vitit 1981 deri në vitin 1986/87 përmes librave, peticioneve, artikujve në gazeta (ku kanë paraprirë Politika me pjesën e vetë Tingëllimet dhe reagimet dhe Veçernje novosti) rriten disponimi antishqiptar që elita intelektuale serbe në fund e ka artikuluar në Memorandumin e ASSHA - fushata antishqiptare është reflektuar edhe përmes turneut të eshtrave të knez Lazarit anembanë Jugosllavisë që u organizua nga KOS-i nga Vidovdani në vitin 1988 deri në muajin gusht të vitit 1989. Të gjitha këto veprime kanë paraqitur një terren përgatitor për mobilizimin nacionalist të popullit serb të orientuar drejt "të tjerëve", dhe më së shumti të fokusuar drej dehumanizimit të popullsisë shqiptare në Kosovë.

**26-27 shkurt:** Pas mbledhjes së zgjeruar të Presidencës të RSFJ-së, në territorin e KAS të Kosovës është shpallur gjendja e luftës dhe në Kosovë u dërgua armata federale me tanke me përkrahjen e forcave shtesë të milicisë federale. Të nesërmen minatorët ngadalë dalin nga gropat pasi Morina (përkohësisht) dha dorëheqjen.

**28 shkurt:** Në Beograd, mblidhet një masë prej 600.000 njerëz përpara Kuvendit Federal si përgjigje të protestave të Kosovës. Brohoritet "Na jepni armë!" dhe "Arrestoni Vllasin!". Në protestë, është fishkëlluar fjalimi i Raif Dizdareviqit, kryetarit të atëhershëm të Presidencës të RSFJ-së, i cili ka bërë thirrje për unitetin e popullit të Jugosllavisë. Në miting Slobodan Millosheviq njoftoi arrestimin e Azem Vllasit, që do të ndodhë edhe tri ditë pas protestës.

Në fillim të marsit të po atij viti, policia në Kosovë arrestoi gjithsej 240 figura të shquara të nacionalitetit shqiptar, duke përfshirë Vllasin, për kundërshtimin e ndryshimeve në Kushtetutë. Pas demonstratave të shqiptarëve në fund të marsit 1989, sipas Human Rights Watch-it, policia vrau 24 veta.<sup>28</sup>

Përfaqësuesit shqiptarë në Kuvendin e Kosovës bojkotuan votimin për këtë çështje më 23 mars të vitit 1989, por përkundër dështimit të propozimit për të plotësuar shumicën e kërkuar prej dy të tretave, propozimet për ndryshimin e kushtetutës u pranuan zyrtarisht, që do të konfirmoheshin nga Kuvendi Serb më 28 mars.

**28 qershor:** Rritja e Millosheviqit në pozitën e mbrojtësit të popullit serb në të gjithë Jugosllavinë u bë e pavdekshme më 28 qershor të vitit 1989 në Gazimestan, gjatë kremtimit të 600 vjetorit të Betejës së Kosovës. Në fjalimin e tij, Millosheviq e quajti Kosovën zemrën e Serbisë, e cila më vonë u bë një parullë politike e pranuar gjerësisht. Atëherë, para rreth 300.000 njerëzve, tha se "as betejat e armatosura nuk përjashtohen", e cila sot interpretohet rregullisht si shpallja e luftërave jugosllave: "Ne jemi përsëri para betejave dhe në beteja. Ato nuk janë të armatosura, edhe pse si të tilla nuk janë përjashtuar ende."

Fjalimi i Millosheviqit simbolizoi fundin e idesë jugosllave, dhe ai u bë udhëheqësi kombëtar i serbëve nga udhëheqësi komunist i Serbisë. Lidhur me triumfin e Gazimestanit të Millosheviqit, Rugova (1989) shqiptoi fjalë thujse profetike: "Gazimestani është një manifestim shovinist. Nuk kanë luftuar vetëm serbët kundër turqve, në betejë kanë marrë pjesë edhe shqiptarët, kroatët dhe boshnjakët. Kjo është një ngjarje me rëndësi për të gjitha kombet jugosllave. Përshtypja ime është se në Jugosllavi ka forca që pothuajse mezi presin veprime terroriste në Kosovë. Unë vetëm mund t'i paralajmëroj serbët se kurdo që një komb të vogël, dhe serbët janë një vend i vogël, është përpjekur të vendosë dominimin e vetë në Ballkan, kjo ka përfunduar me tragjedinë e tij personale."<sup>29</sup>

Prokuroria e Hagës pikërisht fjalimin e Millosheviqit e tregoi si dëshmi për qëllimet e tij të luftës. Prokurori Jeffrey Nice tha në gjyq se "një betejë e armatosur, lufta, nuk ishte përjashtuar, madje edhe në atë moment". Në Vidovdan më vitin 1989, me 5000 autobusë, 50 trena të rregullt dhe të

27 Damjan Pavlica, Historia Bashkëkohore e Kosovës, Peščanik, 19.09.2011: <http://bit.ly/2y5BXG7>;

28 Milosh Qiriq, Bombardimi për fillestarët, Peščanik, 23.02.2012: <http://bit.ly/2xYZ7xe>;

29 Damjan Pavlica, Historia Bashkëkohore e Kosovës, Peščanik, 19.09.2011: <http://bit.ly/2y5BXG7>;

planifikuar dhe disa dhjetëra mijëra makina në një mbledhje arritën një numër i paparë njerëzish. Pas mbarimit të fjalimit, turma këndoi "Kush e thotë, kush gënjen se Serbia është e vogël.

### 1990 - 1992.

Pasi u shpërbë Kuvendi i Kosovës në qershor të vitit 1990, 114 prej 180 deputetëve të saj u përpoqën të shpallnin pavarësinë e Kosovës nga Serbia më 2 korrik, pikërisht si një republikë e plotë brenda RSFJ-së. Ky vendim u shpall gjithashtu i paligjshëm nga Serbia dhe RSFJ-ja, kështu që më 7 shtator, 111 deputetë, të cilët fshehurazi u takuan në Kaçanik, deklaruan një Republikë të pavarur të Kosovës. Prandaj atëherë kundër tyre u ngritën padi. Në dhjetor të atij viti, shqiptarët e Kosovës bojkotuan zgjedhjet për Kuvendin e Serbisë.

Në shtator të vitit 1991, anëtarët e Kuvendit të Kosovës, të cilët vazhduan t'i rezistojnë përpjekjeve të autoriteteve serbe për të deklaruar aktivitetin e tyre të paligjshëm, organizuan një referendum mbi sovranitetin, në të cilin, sipas të thënave të tyre, dolën 87% e votuesve kombëtarë shqiptarë, dhe të gjithë votuan për pavarësinë. Qeveria e koalicionit të Kosovës u formua në tetor dhe mori një njohje diplomatike të Shqipërisë më 22 tetor të atij viti.

Qeveria e Kosovës ka pretenduar që të ketë forcat e veta policore dhe që aktivitetet e veta t'i financojë nga mbledhja e taksave nga popullata shqiptare e Kosovës, por ajo duhet të punonte jashtë institucioneve zyrtare me qëllim që t'i shmangej arrestimit të anëtarëve të saj nga policia serbe dhe forcat e sigurisë. Zgjedhjet e para paralele në Kosovë u organizuan në maj të vitit 1992. Në atë kohë kishin filluar luftërat mbi trashëgiminë e ish Jugosllavisë, RSFJ-ja pushoi së ekzistuari dhe katër nga gjashtë republikat e saj shpallën pavarësinë, ndërsa Serbia dhe Mali i Zi u bashkuan në formimin e Republikës së re Federale të Jugosllavisë (RFJ) në prill të vitit 1992.<sup>30</sup>

### 1992 - 1997.

Gjatë gjysmës së parë të viteve të 1990-ta, Kosova u bë një shtet policor i qeverisur nga Beogradi. Pasi autoritetet e Beogradit morën përsipër institucionet krahinore, qindra mijëra shqiptarë të Kosovës u shkarkuan nga institucionet shtetërore dhe firmat shoqërore. Forcat serbe të sigurisë kanë shkelur vazhdimisht të drejtat e njeriut. Dhuna policore, arrestimet arbitrare dhe tortura ishin dukuri të zakonshme.

Ndërsa lufta shpërtheu në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë, popullsia shumicë shqiptare e krahinës po braktiste rezistencën pasive, duke refuzuar të merrte pjesë në strukturat politike serbe, duke mos dalur në votime dhe duke bojkotuar regjistrimin e popullsisë. Pas marrjes së institucioneve krahinore, autoritetet serbe mbyllën shumicën e shkollave në gjuhën shqipe dhe nuk u dhanë më rroga mësuesve të shkollave të mesme shqiptare. Shqiptarët e Kosovës filluan ndërtimin jo të dhunshëm të institucioneve të tyre paralele, siç janë arsimiti, kujdesi shëndetësor dhe sistemi i taksave. Një sistem paralel i shkollave private u organizua në bazë të donacioneve dhe taksave. Nxënësit dhe studentët shqiptarë ndoqën mësimet në shtëpitë private, kompanitë bosh dhe ndërtesat e braktitura të shkollave.

Pushteti i Millosheviqit nuk lejoi zhvillimin e institucioneve paralele në Kosovë, dhe policia serbe hyri vazhdimisht në institucionet arsimore dhe të tjera të shqiptarëve të Kosovës. Pjesëtarët e forcave të sigurisë në mënyrë rutinore kanë maltretuar, arrestuar dhe rrahur mësuesit, studentët dhe administratorët e shkollave shqiptare. Kjo periudhë u konsiderua nga shqiptarët si një periudhë e "regjimit të egër, totalitar, ushtarako - policor" nën të cilin vuajti shumë popullsia shqiptare.

Udhëheqësi i shqiptarëve të Kosovës, Ibrahim Rugova, gjatë viteve të 1990-ta ishte i njohur për avokimin e rezistencës paqësore ndaj regjimit të Slllobodan Millosheviqit, prandaj ai u quajt "Gandi i Ballkanit". Në gjysmën e parë të viteve të 1990-ta, strategjia e Rugovës e rezistencës jo të dhunshme pati mbështetje të gjerë nga popullata shqiptare. Pas përfundimit të luftërave në Kroaci dhe Bosnjë në 1995 dhe pavarësisë së tyre të plotë, filloi të merrej në pyetje strategjia e padhunshme dhe në mesin e shqiptarëve kishte një numër në rritje të atyre që mbronin rezistencën e armatosur.

Gjatë vitit 1996, autoritetet e Millosheviqit vendosën në Kosovë rreth 16.000 refugjatë serbë nga Bosnja dhe Kroacia, disa prej tyre pa vullnetin e tyre.<sup>31</sup>

Në të njëjtin vit u formua Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila në periudhën nga viti 1996 deri në vitin 1999, nga grupi i shpërndarë i guerrillasve, u shndërrua në një lëvizje të armatosur dhe pastaj në forcë të armatosur. Me taktikën e vet, UÇK-ja shpesh e solli popullatën civile në rrezik. Njësitë e UÇK-së ndonjëherë kanë bërë prita, ose nga fshatrat kanë sulmuar pozicionet e veçanta të policisë dhe ushtrisë, dhe pas kësaj janë tërhequr, dhe kështu i kanë vënë civilët në rrezik të hakmarrjes. Pas sulmeve të tilla, ka pasur edhe krime me përmasa më të mëdha, të cilat kishin edhe më shumë ndikim në popullarizimin e luftës së UÇK-së dhe ka kontribuar në ndërkombëtarizimin e konfliktit. Gjithashtu, elemente të caktuara të UÇK-së janë gjithashtu përgjegjëse për sulmet ndaj serbëve, romëve dhe popullatës tjetër shqiptare, si edhe ndaj shqiptarëve të Kosovës, kundërshtarëve politikë.<sup>32</sup>

Më 1 shtator të vitit 1996, Slllobodan Millosheviq dhe Ibrahim Rugova veç në Beograd, përkatësisht në Prishtinë, nënshkruan marrëveshjen për normalizimin e sistemit arsimor në Kosovë. Teksti i marrëveshjes përmban vetëm disa paragrafë, ku më i rëndësishmi është ai "marrëveshja, për shkak të vlerave të saj shoqërore dhe humanitare, mbi çdo debat politik" dhe ai që parasheh formimin e një komisioni të përzier të ngarkuar për zbatimin e saj. Është pak e njohur për publikun se ekziston një aneks i marrëveshjes së Millosheviqit-Rugovës, të ashtuquajturit dokumenti i Romës që përmban një listë të objekteve ku duhet të kthehen nxënësit dhe studentët shqiptarë. Marrëveshja e publikuar nuk përmban dispozita për çështjet siç janë financimi, kurrikula dhe programet, njohja e diplomave dhe ndarja e hapësirës në të cilën mësimi zhvillohet në gjuhë të ndryshme.

Siç thuhet në Raportin e Fondit për të Drejtën Humanitare<sup>33</sup>, në gjithçka tjetër, situata në arsimin e Kosovës ishte e njëjtë me atë përpara nënshkrimit të marrëveshjes. Pas një vonese një vjeçare, grupi i përzier u takua përsëri në fillim të tetorit të vitit 1997 në Prishtinë dhe Beograd. Bisedimet përfunduan pa asnjë ndryshim dhe me fajësimin e ndërsjellë për një rezultat të tillë. Pakënaqësia për moszbatimin e marrëveshjes në fillim të 1 tetorit të viti 1997, nxorri më shumë se njëzet mijë studentë shqiptarë në rrugët e Prishtinës, ku ata synonin që me shëtitje në heshtje nëpër qytet të shprehnin protestën e tyre. Policia përdori gaz lotsjellës dhe shkopinj të përëndarë studentët e grumbulluar. Forca u përdor gjithashtu kundër qytetarëve të cilët në pjesë të tjera të qytetit prisnin ardhjen e rreshtit të studentëve.

## Kronologjia e luftës së Kosovës

### 1998.

Krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit nga forcat jugosllave (njësitë e Ushtrisë Jugosllave dhe policisë, si dhe njësitë paraushtarake) në Kosovë kanë qënë fokusi i vëmendjes ndërkombëtare që nga fillimi i bombardimeve të NATO-s më 24 mars të vitit 1999. Civilët kanë qënë objekt i krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare që nga fillimi i konfliktit në Kosovë, ose që nga janari i vitit 1998. Më poshtë është përmendur kronologjia e krimeve më të mëdha të luftës të listuara në dokumentacionin dhe raportet e organizatave të ndryshme, dhe shumica e raporteve të Human Rights Watch-it<sup>34</sup> dhe raporteve të OSBE-së "Siç është parë, ashtu është thënë"<sup>35</sup> nga janari 1998 deri në qershor të vitit 1999.

Ofensiva e forcës të policisë si dhe Ushtrisë së Jugosllavisë kishin qëllim të qartë për të shtypur mbështetjen e rebelëve civilë. Forcat qeveritare kanë sulmuar civilët, shkatërruar sistematikisht qytetet dhe kanë detyruar mijëra njerëz të largohen nga shtëpitë e tyre. Policia në mënyrë rutino-

31 Njësoj, faq.5-6: <http://bit.ly/2x0h6Ec>;

32 Human Rights Report, Sipas urdhërit: Krimet e Luftës në Kosovë, Samizdat B92 (2001), faq.38 : <http://bit.ly/2wfbUin>;

33 FDH, "Arsimi në gjuhën shqipe" (1997): <http://bit.ly/2vTF2rm>;

34 Human Rights Report, War crimes in Kosovo (2001): <http://bit.ly/2wfxM8R>;

35 Analiza e OSBE Misionit verifikues të Kosovës: Siç është parë, ashtu është thënë, OSBE (ODIHR),Edicioni Dokumenta-Fondi për të drejtën humanitare, 1999: <http://bit.ly/2x0h6Ec>;

re ka plaçkitur shtëpitë, ka shkatërruar fshatrat e braktisura, ka djegur të korrurat dhe ka vranë bagëtinë, por gjithashtu ka vranë sipas procedurës së shkurtër - që të gjitha janë shkelje e rregullave të luftës. Shumica e të vranëve dhe të lënduarve ishin civilë. Sipas UNHCR-së, midis majit dhe shtatorit 1998, të paktën 250.000 njerëz u zhvendosën dhe ndërmjet të zhvendosurve ka patur shumë gra dhe fëmijë. Janë sulmuar territoret ku UÇK-ja ishte aktive, si Drenica dhe zona rreth Rahovecit, dhe sidomos zona përgjatë kufirit me Shqipërinë.<sup>36</sup>

**28 shkurt - 1 mars:** Njësitë speciale policore serbe sulmuan komunat Likoshan dhe Çirez në rajonin e Drenicës në Kosovë duke luftuar me helikopterë, automjete të blinduara dhe granata të rënda. Dhjetë anëtarë të familjes Ahmeti u vranë dhe katër vëllezër të familjes Sejdiu vdiqën derisa ishin në paraburgim.<sup>37</sup>

**5 - 7 mars:** Policia Speciale serbe sulmoi në Prekaz të Poshtëm kompleksin familjar të Adem Jasharit, udhëheqësit lokal të UÇK-së. Vlerësohet se janë vranë 58 anëtarë të familjes Jashari, duke përfshirë tetëmbëdhjetë gra dhe dhjetë fëmijë nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare. Të paktën gjashtë shqiptarë etnikë u vranë në rrethana të paqarta në fshatin e afërt Lausha.

**25 maj:** Policia speciale serbe në Lubeniq, një fshat pranë Pejës, ekzekutoi së paku nëntë, dhe ndoshta njëzet e nëntë shqiptarë.

**31 maj:** Vlerësohet se 300 anëtarë të forcave speciale të policisë sulmuan fshatin Novi Poklek (Poklek e Re) në Drenicë. Forcat e policisë kidnapuan dhjetë burra të kombësisë shqiptare, njëri prej të cilëve u gjet i vdekur dhe nëntë u zhdukën dhe supozohet se janë të vdekur. Policia plaçkiti dhe dogji më shumë se njëzet shtëpi.

**19 korrik:** UÇK-ja privoi nga liria rreth tetëdhjetë e pesë serbë gjatë ofensivës në Rahovec më 19 korrik 1998. Tridhjetë e pesë u liruan më vonë, por fati i të tjerëve ishte i panjohur<sup>38</sup>. Sipas të dhënave të Tribunalit, tridhjetë e pesë serbë u zhdukën nga komuna e Rahovecit më 17 dhe 18 korrik. UÇK-ja për pak kohë mori kontrollin e minierës Belaçevac (Bardhi i Madh) afër Obiliqit më 22 korrik. Atë ditë, 9 pjesëtarë të UÇK-së kapën nëntë serbë dhe ata ende janë në listën e të humburve të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar.<sup>39</sup>

**27 gusht:** Krimi më brutal i kryer nga UÇK-a është vrasja e njëzet e dy civilëve serbë në fshatin Kleçkë - policia serbe ka thënë se në fshat gjeti të mbeturat njerëzore dhe një furrë të përdorur për djegien e trupave. Mënyra se si u paraqitën akuzat seriozisht rrezikon besueshmërinë e tyre. Dy shqiptarë të Kosovës, Luan dhe Bekim Mazreku u akuzuan në prill të vitit 2000 në gjyqin e Nishit për vrasjen e dy civilëve serbë në Kleçkë.<sup>40</sup>

**9 shtator:** Trupat e tridhjetë e katër njerëzve, duke përfshirë serbët dhe shqiptarët, u gjetën në liqenin artificial pranë fshatit Glogjane. Provat sugjerojnë se autorët janë anëtarë të UÇK-së.<sup>41</sup>

**27 shtator:** Ofensiva e autoriteteve serbe dhe jugosllave përfundoi në fund të shtatorit me luftime të rënda rreth Suharekës në zonën e Drenicës. Vëzhguesit më 27 shtator zbuluan trupat e njëzet e një civilëve shqiptarë të ekzekutuar në një pyll afër fshatit Gornje Obrinje (Abri të Epërme). Të nesërmen, hulumtuesit e Human Rights Watch-it dhe gazetaret vizituan këtë vend dhe dokumentuan vrasjet, si dhe vrasjen e 13 shqiptarëve të Kosovës në Golubovac.<sup>42</sup>

## **1999.**

**15 janar:** Policia speciale serbe vrau gjithsej dyzet e pesë shqiptarë etnikë në Raçak. Sipas Raportit të Human Rights-it për krimet në Kosovë, sulmi i policisë është shkaktuar ndoshta nga prita e UÇK-së, në të cilën disa ditë më parë u vranë tre policia serb, forcat e policisë u përgjigjën duke

36 Human Rights Report, Sipas urdhërit: Krimet e Luftës në Kosovë, Samizdat B92 (2001), faq. 78: <http://bit.ly/2wfbUin>;

37 Njësoj, faq. 68;

38 KDOM ose Misioni diplomatik i vëzhguesve të Kosovës u krijua pas një marrëveshjeje kompromisi (prej 16. qershorit të vitit 1998) Milosheviq-Jelcin në bazë të të cilës RFJ-a pranoi praninë e vëzhguesve të pavarur që në shtator të vitit 1998 do t'i zëvendësojë Misioni Verifikues i OSBE-së.

39 Njësoj, faq. 84;

40 Njësoj, faq. 84;

41 Njësoj, faq. 84.;

42 Njësoj, faq. 80-81;

qëlluar mbi civilë, torturimin e të zënëve robër, dhe vrasjen sipas procedurës së shkurtër. Masakra në Raçak u dokumentua mirë nga misioni i OSBE-së dhe u dënua menjëherë nga Shefi i Misionit William Walker. Autoritetet jugosllave njoftuan se shqiptarët ishin luftëtarë të UÇK-së dhe se ata u vranë në betejë, dhe kërcënuan se do të dëbojnë Walker-in nga vendi duke e quajtur "përfaqësues dhe mbrojtës të separatizmit dhe terrorizmit". Luiz Arburit, Kryeprokurores së TPNJ, iu ndalua qasja në Kosovë më 18 janar, ku planifikoi të hetonte incidentin në Raçak. Masakra në Raçak shkaktoi zemërim publik në Perëndim dhe qeveritë perëndimore filluan të bien dakord për mënyrën se si diplomacia mund të mbështetej me forcë. NATO intensifikoi kërcënimet me veprimet ushtarake që i kushtëzoi me ndërprerjen e sulmeve ndaj civilëve.<sup>43</sup>

**24 mars:** Me fillimin e bombardimeve të NATO-s, vrasjet kanë ndodhur anembanë Kosovës, por disa shqiptarë të njohur të Kosovës ishin në një objektiv të veçantë. Vrasja e parë e raportuar ishte vrasja e avokatit të shquar dhe aktivistit për të drejtat e njeriut, Bajram Kelmendit dhe dy djemëve të tij, Kastriot dhe Kushtrim Kelmendi në Prishtinë, në natën e 24 Marsit. Edhe shqiptarë të tjerë të shquar u vranë në të njëjtën kohë në pjesë të tjera të Kosovës. Forcat serbe hynë në shtëpinë e një mjeku të shquar në Gjakovë, Dr Izet Hima, më 25 mars dhe e vranë para gruas së tij. Avokati i njohur Urim Rexha dhe lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) Mark Malota u vranë po atë ditë në Gjakovë. Dy aktivistë të lartë të LDK-së në pozita të larta në Mitrovicë u vranë gjithashtu nën rrethana të paqarta: Agim Hajrizi dhe Latif Berisha. Ndoshta shqiptari më i shquar i vranë është Fehmi Agani (i vranë më 6 maj në Fushë Kosovë), një profesor dhe figurë udhëheqëse e LDK-së. Aganin si politikan e ka respektuar shumica e atyre që janë marrë me politikën e Kosovës: partia e tij, UÇK-ja, negociatorët ndërkombëtarë, madje edhe negociatorët serbë.<sup>44</sup>

**25 mars:** Refugjatët raportuan se më shumë se gjashtëdhjetë burra shqiptarë u ekzekutuan në Bela Crkva (Bellacerkë), duke përfshirë njëzet anëtarë të familjes Popaj dhe njëzet e pesë pjesëtarë të familjes Zhuniqi.

**25 mars:** Me analizën e kujdesshme të dëshmimeve në dispozicion për vrasjen masive të dhjetra shqiptarëve të Kosovës, prej të cilëve 42 janë identifikuar, të kryer më 25 mars të vitit 1999 në fshatin Tërnje (komuna e Suharekës), Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH) zbuloi se ekziston një dyshim i arsyeshëm se Bozhidar Deliq, gjenerali në pension dhe 10 persona të tjerë, kryesisht pjesëtarë të UJ-së nga brigada e 549. e motorizuar e UJ-së, të cilën e ka komanduar dhe një pjesë e MPB-së të Serbisë, sipas planit dhe marrëveshjes së mëparshme, kanë kryer ato vrasje dhe se janë përgjegjës penalisht për veprën penale të krimeve të luftës kundër civilëve.

**26 mars:** Më 25 mars të vitit 1999 ose rreth kësaj date, fshatrat Velika Krusha (Krusha e Madhe) dhe Mala Krusha (Krusha e Vogël), (Komuna e Rahovecit) i sulmuan forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Banorët vendas kërkuan strehim në një zonë të pyllëzuar jashtë Krushës së Madhe, ku mund të shihnin oficerët e policisë serbe se si në mënyrë sistematike plaçkitin dhe djegin shtëpitë e vendasve. Në mëngjesin e 26 marsit të vitit 1999, ose rreth asaj dite, policia serbe zbuloi fshatarët në pyll. Policët i urdhëruan gratë dhe fëmijët e vegjël të largoheshin andej dhe të shkolin në Shqipëri. Policët pastaj kontrolluan burrat dhe djemtë dhe u morën dokumentet e tyre personale, dhe më pas i detyruan të ikin me këmbë deri te një shtëpi e braktisur midis pyllit dhe Krushës së Vogël. Kur meshkujt dhe djemtë u mblohdën në shtëpi, policët serbë hapën zjarr ndaj grupit. Pas disa minutash zjarri, policat hodhën kashtë mbi burrat dhe të rinjtë, duke e ndezur atë për të djegur trupat. Për shkak të qitjes dhe zjarrit, rreth 105 shqiptarë të Kosovës, burra dhe djem, u vranë nga policia serbe.<sup>45</sup>

**26 mars:** Një nga krimet më brutale në këtë komunë ka ndodhur më 26 mars të vitit 1999. Sipas aktakuzës për krime lufte në rastin e Suharekës, policë, të armatosur me armë personale, u nisën nga oborri i OUP-in e Suharekës në drejtim të shtëpive pranë rrugës së Reshtanit ku jetonin qytetarë të kombësisë shqiptare. Policët i dëbuan nga shtëpitë që i kontrolluan, plaçkitën dhe dogjën, disa i privuan nga jeta, ndërsa të tjerët, duke i kërcënuar se do t'i vrasin, i detyruan të largohen nga qyteti dhe të ikin në Republikën e Shqipërisë. Një numër të burrave, grave dhe fëmijëve i futën në picerinë lokale "Kalabria", në të cilën hodhën dy granata dore. Pas kësaj, qëlluan me armë të gjithë që jepnin shenja të jetës. Policët e armatosur vranë edhe të sjellurin më vonë Jashar Berishën, ndërsa Abdullah Eshlanin e nxorën nga njësia e paraburgimit Suharekë, e çuan deri në shtëpinë e Nexhad Berishës, ku e pushkatuan. Punëtorët e MPB-së Prizren dhe punëtorët e ndërmarrjes komunale të Prizrenit "Higjena" me

43 Njësoj, faq. 92;

44 Njësoj, faq. 179-182;

45 Aktpadia e tretë e plotësuar për çështjet para TPNJ/ICTY Shainoviq e të tjerë (IT-05-87): <http://bit.ly/2jvzvFC>;

kamiona transportuan trupat dhe i varrosën në një varr masiv në fushën ushtarake për qitje afër fshatit Ljubizhda dhe Korusha. Në fillim të prillit të vitit 1999, me urdhër të Vlastimir Gjorgjeviqit, një varr masiv është gërmuar me makineritë e ndërtimeve, dhe eshtrat u transferuan në kamionë frigoriferë, të cilët anëtarët e Njësisë Speciale Anti-terroriste (NJS) të MPB-së të Serbisë i transportuan në Batajnicë dhe rivarrosën. Në këtë krim, u vranë gjithsej 48 vetë, nga të cilët 46 anëtarë dhe anëtare të familjes Berisha.

**28 mars:** Më 28 mars, në Podujevë, në oborrin e familjes Gashi, anëtarët e njësisë "Shkorpionët" gjuajtën me pushkë automatike disa dhjetëra predha drejt grupit prej 19 civilësh shqiptar, gra dhe fëmijë. "Shkorpionët", të cilët ishin pjesë e Njësisë Speciale Anti-terroriste (NJS) të MPB-së të Serbisë, plagosën atëherë deri në vdekje 14 civilë. Viktima më e vjetër ishte 69 vjeç, ndërsa më e re ishte dy vjeçe. Në këtë krim u vranë anëtarët e familjeve Bogujevci dhe Duriqi.

**1 - 4 prill:** Forcat jugosllave të sigurisë vranë të paktën dyzet e shtatë burra në një fushatë të dhunshme të shpopullimit në Gjakovë.

**27 prill:** Sipas dëshmitarëve, në mëngjesin e hershëm të 27 prillit, njësitë speciale policore serbe dhe paramilitare, së bashku me UJ-në, sistematisht dëbuan të gjithë shqiptarët e Kosovës nga fshatrat midis Gjakovës dhe Junikut - zona pranë kufirit me Shqipërinë. Fshatarët nga këto vende u detyruan të shkonin në rrugën drejt Mejës. Forcat e sigurisë i nxorën burrat nga kolona dhe i ndanë nga familjet e tyre. Sipas dokumentacionit të KNKK-së, thuhet se janë rrëmbyer 282 burra në Mejë. Numri i saktë i viktimave shqiptare nuk dihet, por vlerësohet se ndoshta janë vrarë 300 burra nga moshë 14 deri në 60 vjeçare.

**14 maj:** Herët në mëngjesin e 14 majit të vitit 1999, forcat serbe të sigurisë hynë në fshatin Qyshk, disa kilometra në lindje të Pejës. Rreth orës 8:30 të mëngjesit, forcat e sigurisë me uniforma të gjelbra ushtarake me fytyra të ngjyrosura dhe maska veçuan nga grupi gratë, fëmijët dhe burrat e moshuar, burrat që nuk arritën të iknin. I kanë kërcënuar dhe morën para, stoli dhe sendet të tjera me vlerë nga më shumë se dyqind fshatarë. U shkatërruan dokumentat. Më pas veçuan 32 burra nga 19 deri në 69 vjeç, i ndanë në tre grupe dhe i çuan në tre shtëpi të ndryshme, ku i detyruan të rreshtoheshin. Pastaj, në çdo shtëpi, hapën armë zjarri nga armët automatike.

**22 maj:** Një nga krimet më të rënda të kësaj lufte ndodhi në burgun e Dubravës, institucionin më të madh penitenciar në Kosovë, kur forcat e sigurisë të Republikës së Serbisë kryen një masakër të burgosurve pas sulmeve ajrore të NATO-s. Duke ndjekur aktivitetet e forcave serbe dhe ushtrisë jugosllave në këtë zonë, NATO bombardoi burgun më 19-të dhe përsëri më 21 maj të vitit 1999, duke vrarë të paktën nëntëmbëdhjetë të burgosur shqiptarë dhe duke krijuar kaos në këtë institucion. Qeveria jugosllave thotë se disa të burgosur shfrytëzuan bombardimet dhe u përpoqën të arratiseshin nga burgun, ndërsa forcat e sigurisë u përpoqën të mbanin rendin. Më 22 maj, zyrtarët e burgut urdhëruan që rreth 1.000 të burgosur të rreshtoheshin në oborrin e burgut. Pas disa minutash, hapën zjarr nga armë automatike nga muret e burgut dhe kullat e gardianëve dhe hodhën bomba mbi ta, ku u vranë të paktën 70 të burgosur. Gjatë 24 orëve të ardhshme, rojet, policia speciale dhe, ndoshta, paramilitarët sulmuan të burgosurit që ishin fshehur nëpër ndërtesat e burgut, bodrume dhe kanalizime, duke vrarë të paktën edhe 12 persona të tjerë.

## Proceset para Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ/ICTY)

Në çështjen **Limaj dhe të tjerët**, të paditurve (Limaj, Musliu dhe Bala) u vunë përsipër krime të kryera në kamp-burgun e Llapushnikut. Limaj dhe Musliu u shpallën të pafajshëm, ndërsa Bala u dënua me 13 vjet burg për torturë, trajtim mizor dhe vrasje.<sup>46</sup>

Në aktakuzën për çështjen **Haradinaj dhe të tjerët** (Haradinaj, Balaj dhe Brahimaj) thuhet se pas 24 marsit të 1998-ës, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e Ramush Haradinajt organizuan një fushatë ushtarake për të marrë kontrollin e zonës midis fshatrave Glogjan dhe Deçan (zona operacionale e Dukagjinit). Të gjithë të akuzuarit në këtë çështje u liruan nga padia.<sup>47</sup>

46 Çështja para TPNJ/ICTY, Ljimaj e të tjerë (IT-03-66): <http://bit.ly/2xfiiRk>;

47 Çështja para TPNJ/ICTY, Haradinaj e të tjerë (IT-04-84 i IT-04-84bis): <http://bit.ly/2qXE8nF>;

Në aktakuzën e dytë e TPNJ-së Sllobodan Millosheviqit nga 29 qershori i vitit 1999, është përmendur se mes 1 janarit të vitit 1999 dhe 20 qershorit të vitit 1999, Sllobodan Millosheviq ka marrë pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale (NPK) së bashku me disa persona të tjerë. U theksua se qëllimi i NPK-së ishte të dëbohej një pjesë e konsiderueshme e popullatës shqiptare të Kosovës nga Kosova në një përpjekje për të siguruar kontrollin e mëtejshëm serb mbi krahinën. Gjatë kësaj periudhe, forcat e Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) dhe Serbisë, duke vepruar sipas udhëzimit, me nxitje ose mbështetjen e NPK-së, zbatuan një fushatë terrori dhe dhune të drejtuar ndaj civilëve shqiptarë në Kosovë. Pasoja ishte deportimi i dhunshëm i rreth 800.000 civilëve shqiptarë në Kosovë. Për të mundësuar dëbimet dhe zhvendosjet, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë qëllimisht krijuan një atmosferë frike dhe shtypjeje përmes përdorimit të forcës, kërcënimeve me forcë dhe akteve të dhunës. Anëmbanë Kosovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sistematikisht granatuan qytete dhe fshatra, dogjën shtëpi dhe ferma, dëmtuan dhe shkatërruan monumente kulturore dhe objekte fetare të shqiptarëve të Kosovës, vranë civilë shqiptarë të Kosovës dhe keqpërdoruan seksualisht shqiptarët e Kosovës. Sllobodan Millosheviq vdiq në njësinë e paraburgimit në Sheveningen (Hagë) më 11 Mars 2006, ndërsa procesi kundër tij u ndërpre në 14 mars 2006.<sup>48</sup>

**Vlastimir Gjorgjeviq**, i cili prej 1 qershorit 1997 deri më 30 janar të vitit 2001 ishte ndihmës i Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë (MPB) dhe Shef i Departamentit të Sigurisë Publike (DSP) të MPB-së dhe përgjegjës për të gjitha njësitë dhe stafin e DSP-së në Serbi, duke përfshirë Kosovën, nga 1 janari deri më 20 qershor 1999, u dënua me 18 vjet burg për deportim, veprime të tjera çnjerëzore (transferim me forcë), vrasje, persekutime në baza politike, racore dhe fetare (krime kundër njerëzimit) dhe vrasje (shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës). Forcat e Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) dhe Serbisë, duke vepruar sipas udhëzimeve, me nxitje, ose mbështetjen e Gjorgjeviqit, kryen vepra penale që çuan në dëbimin me forcë të rreth 800.000 civilëve shqiptarë të Kosovës, vrasjen, shkatërrimin dhe shfarrosjen e monumenteve kulturore.<sup>49-</sup>

Të pandehurit në çështjen **Shainoviq dhe të tjerët** (Shainoviq, Ojdaniq, Pavkoviq, Lazareviq, Lukiq, Milutinoviq) u akuzuan për krime të kryera gjatë fushatës së terrorit dhe dhunës kundër popullatës së shqiptarëve të Kosovës në fillim të vitit 1999. Thuhet se secili nga të akuzuarit individualisht ka marrë pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale me qëllim të ndryshimit të balancës etnike në Kosovë në përpjekje për të siguruar kontrollimin e mëtejshëm të autoriteteve serbe. Ky plan u zbatua përmes mjeteve të dënueshme, duke përfshirë dëbimet, vrasjet, transferimet e dhunshme dhe persekutimet e shqiptarëve të Kosovës. Millan Millutinoviq u lirua nga të gjitha akuzat, ndërsa të tjerët u dënuan me disa vjetë burgim.<sup>50</sup>

## Proceset para gjykatave vendore

### Podujeva

Për krimin në Podujevë, Departamenti për krime të luftës të Gjykatës së Lartë në Beograd, dënoi përfundimisht pjesëtarët e "Shkorpionave", Zhelko Gjukiq, Dragan Mediq e Dragan Borojeviq, me nga 20 vjetë burg, ndërsa Miodrag Shollajën me 15 vjetë burg. Pjesëtari i "Shkorpionave", Sasha Cvjetan, më vitin 2005. është dënuar me dënim përfundimtar me 20 vjetë burg.<sup>51</sup>

### Suhareka

Departamenti për krime të luftës të Gjykatës së Lartë në Beograd ish komandantit të stacionit policor të Suharekës, Radojko Repanoviqit, i shprehu dënimin me burg prej 20 vjetësh për veprën penale krim i luftës kundër popullatës civile.<sup>52</sup> -

48 Çështja para TPNJ/ICTY, Millosheviq(IT-02-54): <http://bit.ly/2fd317Q> ;

49 Çështja para TPNJ/ICTY, Gjorgjeviq (IT-05-87/1): <http://bit.ly/2wS8Ur1>;

50 Çështja para TPNJ/ ICTY, Shainoviq e të tjerë (IT-05-87): <http://bit.ly/2gYo84H>;

51 Çështja para Gjykatës së Lartë të Departamentit për krime të luftës, Podujevë II (Gjukiq dhe të tjerët): <http://bit.ly/2y3S9GX>;

52 Çështja para Gjykatës së Lartë të Departamentit për krime të luftës, Suharekë (Mitroviq dhe të tjerët): <http://bit.ly/2x2Aym7>;

### Rahovec

Duke vendosur sipas ankesës, Gjykata e Apelit në Beograd, shpalli fajtor një person për veprën penale krim i luftës i bërë më datën 09.05.1999. në dalje të komunës së Rahovecit. Ky person, si pjesëtar i MPB-së të RS-së, gjatë kryerjes së detyrës së sigurimit të qarkullimit, ka vararë civilin.<sup>53</sup>

### Tërnje (procesi i shkallës së parë)

Të akuzuarit ngarkohen se si pjesëtarë të brigadës së 549-të të motorizuar të UJ-së, më datën 25 mars të vitit 1999, në fshatin Tërnje, (komuna e Suharekës në Kosovë), kanë marrë pjesë në vrasjen e së pakti 27 civilëve shqiptarë, ndërmjet të cilëve ishin 12 gra dhe katër fëmijë. Si komandant i bataljonit të Prapavijës të br.mt. të UJ-së Gavrilloviq pak para sulmit në fshat, mblodhi epororët vartës, ndërmjet të cilëve ishte edhe Kozlina, dhe u dha urdhër, duke u treguar me dorë në drejtim të fshatit, se "nuk guxon të ketë të gjallë". Kozlina ngarkohet se si rreshter dhe komandant i grupit të luftës, duke vepruar sipas urdhërave të Gavrilloviqit, vrau Voci Maliqin duke e qëlluar me një plumb në krahë me pushkë automatike, dhe u tha të tjerëve: "Kështu bëhet". Kozlina ngarkohet edhe për vrasjen e 16 civilëve.<sup>54</sup>

### Qushka (procesi i shkallës së parë, gjykimi i përsëritur)

Trupi gjyqësor i Departamentit për krime të luftës të Gjykatës së Lartë në Beograd më 11 shkurt të vitit 2014 morri aktvendimin me të cilin nëntë të akuzuar janë shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale krim i luftës kundër popullatës civile dhe janë dënuar me burg nga dy deri në dymbëdhjetë vjetë, ndërsa dy të akuzuar, Radosllav Bërnoviç dhe Velko Koriqanin, janë liruar nga paditë për shkak të mungesës së provave. Gjykata e Apelit, më datën 26 shkurt të vitit 2015. morri vendim me të cilin respektoi ankesat e të gjithë mbrojtësve, anuloi aktvendimin e shkallës së parë dhe çështjen ia ktheu gjykatës së shkallës së parë për rigjykim. Procesi i përsëritur nisi më datën 8 qershor të vitit 2015.<sup>55</sup>

## Kriza e Kosovës dhe roli i komunitetit ndërkombëtar

### 1998 - 2000.

Në shtator të vitit 1998, Këshilli i sigurimit i KB-së miraton Rezolutën 1199<sup>56</sup>, me të cilën nga serbët dhe shqiptarët kërkohet që t'i ndalin sulmet dhe të fillojnë bisedimet. Paralelisht me këtë, NATO njofton se është ngritur përgatitja ushtarake e aleancës dhe miratoi aktin e paralajmërimit, si paralajmërim për operacionet ajrore në Kosovë. Në tetor, kur u bë i qartë aksioni i aleancës së NATO-s, delegacioni i kryesuar nga i dërguari special i SHBA-së, Riçard Hollbruku, vjen në Beograd, në përpjekjen e fundit që të bind Millosheviqin që të respektojë Rezolutën 1199. Disa ditë pas bisedave intensive më 13 tetor të vitit 1998, u arrit marrëveshja, dhe me këtë u shty ndërhyrja ushtarake e NATO-s. Sipas Marrëveshjes, është dashur që Millosheviq të tërhiqte nga Kosova njësitë speciale dhe ato policore. Beogradi ra dakord që të lejojë qasjen e 2.000 vëzhguesve civilë të OSBE-së me detyrë që të mbikqyrin dhe vërtetojnë zbatimin e marrëveshjes.<sup>57</sup>

Edhe pse përfaqësuesit amerikanë kanë theksuar se marrëveshja Hollbruk-Millosheviq hap mundësinë për një lloj autonomie të Kosovës, Millosheviq marrëveshjen e përshkruajti si garanci e tërësisë teritoriale serbe dhe vazhdim të kontrollit serb ndaj Kosovës. Përfaqësuesit e shqiptarëve të Kosovës, shprehën dyshimin se me ardhjen e vëzhguesve ndërkombëtarë do të parandalohen konfliktet e mëtejshme, ndërsa Ibrahim Rugova ka bërë thirrje që menjëherë të dërgohen trupat në Kosovë, gjë që e ka konsideruar si të vetmen mundësi që shqiptarët e Kosovës të mbrohen nga njësitë speciale serbe. Për herë të parë pas Luftës së Dytë botërore, më 5 tetor të vitit 1998, në RFJ është shpallur gjendja e rrezikut të drejtpërdrejtë të luftës.

53 Arkivi i Fondit për të drejtën humanitare, Transkriptet nga gjykimet para Gjykatës së Lartë në Beograd: çështja Rahovec (Boban Petkoviç e Gjorgje Simiq): <http://bit.ly/2gWVWHiz>;

54 Fondi për të drejtën humanitare, Raporti për gjykimet për krimet e luftës në Serbi për vitin 2016., faq. 62: <http://bit.ly/2wUAOAX>;

55 Njësoj, faq 68;

56 Rezoluta e KS-së të KB-së nr. 1199: <http://bit.ly/2x0cjUM>;

57 Milosh Qiriq, Bombardimi për fillestarët, Peščanik: <http://bit.ly/2xYZ7xe>;



Nga mesi i muajit në Beograd vijnë përfaqësuesit e NATO-s me qëllim të nënshkrimit të marrëveshjes përfundimtare të vërtetuar gjatë bisedave Millosheviq-Hollbruk. Megjithatë, atëherë Millosheviqi nuk lidhi marrëveshje me ta, por u përpoq që t'i shmanget zbatimit të disa prej dispozitave të marrëveshjes. Në atë kohë, në mbledhjet e Kryeshtabit të Ushtrisë së Jugosllavisë, është folur edhe për rjedhën e bisedave me Hollbrukun, ndërsa kryeshefi i Kryeshtabit Momçillo Perishiç, deklaroi hapur se rreziku nga ndërhyrja ushtarake në territorin e RFJ-së "ende nuk është hequr". Nga fundi i vitit, bëhet përsëri eskalimi i konflikteve në Kosovë, komandanti i forcave të NATO-s për Europën, Vesli Klark, vjen përsëri në Beograd ndërsa bisedimet me Millosheviqin përfundojnë pa rezultate konkrete.

Ndërkohë, ambasadori amerikan në Republikën e Maqedonisë, Kristofer Hil, ka drejtuar procesin e mediacionit ndërmjet delegacionit shqiptar, që e ka udhëhequr Rrugova, dhe qeverisë jugosllave dhe serbe. Pikërisht këto takime kanë formuar atë që do të jetë plani i paqes për të cilin do të bisedohej gjatë periudhës së okupacionit të planifikuar të NATO-s në Kosovë. Gjatë periudhës dy javore janë shpeshuar kërcënimet, gjë që shkaktoi kulminimin e urdhërit të NATO-s për aktivim. NATO ishte gati që të niste sulmet ajrore, ndërsa Riçard Hollruk vajti në Beograd me shpresë se do të arrijë marrëveshje me Millosheviqin. Zyrtarisht, komuniteti ndërkombëtar, kërkoi luftë. Në veçanti është kërkuar që Jugosllavia të përfundojë ofensivat e veta kundër UÇK-së derisa përpiqet që të bind UÇK-në që të hedh ofertën e vetë për pavarësi. Për më tepër, është përpjekur edhe bindja e Millosheviqit që t'u lejojë forcave të paqes të NATO-s që të hyjnë në Kosovë. Kjo, siç thonë, ka mundësuar që procesi paqësor i Kristofer Hilit të vazhdojë dhe të sjellë marrëveshjen paqësore.

NATO më 13 tetor të vitit 1998 dha urdhëra për aktivizimin e sulmeve të kufizuara ajrore në Jugosllavi, që duhet të fillonin brenda 96 orëve. Më 15 tetor është nënshkruajtur Marrëveshja për misionin verifikues<sup>58</sup>, dhe kështu filloi ndërprerja e zjarrit, ndërsa afati për tërheqjen e forcave të rënda të armatosura është zgjatur deri më 27 tetor. Tërheqja e Serbisë filloi më datën 25 tetor të vitit 1998 ose rreth kësaj date, ndërsa operacioni Eagle Eye (pjesa e misionit verifikues i ngarkuar për monitoringun e tërheqjes të forcave të armatosura) nisi më 30 tetor.

Misioni verifikues i Kosovës ishte kontigjent i madh i vëzhguesve të paarmatosur paqësor të Organizatës për siguri dhe bashkëpunim në Europë që u vendosën në Kosovë. Lufta vazhdoi në dhjetor të vitit 1998, pasi që të dyja palët e ndërprejnë ndërprerjen e zjarrit, dhe rritja e dhunës kulminizoi me vrasjen e Zvonko Bojaniqit, kryebashkiakut të komunës Fushë Kosovë. Pushteti jugosllav u përgjigj me nisjen e represionit kundër pjesëtarëve të UÇK-së dhe civilëve.

## **1999.**

**15 janar:** Janë zbuluar trupat e 45 shqiptarëve në fshatin Raçak.

**16 janar:** Shefi i Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë, Kristofer Voker, i atribuon masakrën në Raçak forcave serbe të sigurisë. Komuniteti ndërkombëtar dënon masakrën.

**18 janar:** Komuniteti ndërkombëtar shpreh zemërimin për vendimin e Kryeministrit jugosllav për të dëbuar ambasadorin Walker pas komenteve të tij për Raçkun. Walkerit i jepen 48 orë për t'u larguar nga vendi.

**21 janar:** Komisioneri i Lartë i KB-së për refugjatët thotë se 20.000 njerëz u larguan nga shtëpitë e tyre që nga fundi i dhjetorit, nga të cilat rreth 5.000 janë vetëm nga zona e Raçkut.

**27 janar:** Ministri rus i punëve të jashtme Ivanov dhe sekretarja e shtetit të SHBA-së Medlin Olbrajt takohen dhe japin një deklaratë të përbashkët mbi Kosovën.

**29 janar:** Grupi i kontaktit nga gjashtë vende takohet në Londër dhe u jep një ultimatum të dy palëve për të marrë pjesë në bisedimet e paqes në Francë duke filluar nga 6 shkurti. Këto bisedime zgjasin një javë, me mundësinë e zgjatjes së javës së dytë, nëse bëhet përparim me negociatë.

**30 janar:** NATO pajtohet përsëri se Sekretari i Përgjithshëm mund të miratojë sulmet ajrore kundër objektivave në territorin jugosllav.

**1 shkurt:** Udhëheqësit politikë në Kosovë thonë se ata do të marrin pjesë në bisedimet e propozuara të paqes.

**2 shkurt:** Zëdhënësi i UÇK-së thotë se UÇK-ja gjithashtu do të dërgojë përfaqësues në bisedime, të cilët do të plotësojnë delegacionin shqiptar.

**4 shkurt:** Pas votimit në parlament, qeveria serbe pranon të marrë pjesë në negociata.

**6 shkurt:** Bisedimet filluan në Rambuje, në Francë, nën kujdesin e Grupit të Kontaktit. Ato drejtohen nga tre bashkë-ndërmjetësues që përfaqësojnë Shtetet e Bashkuara, Bashkimin Evropian dhe Federatën Ruse. Sekretarja e Shtetit të Amerikës Olbrajt personalisht ndërmjetëson negociatat.

**23 shkurt:** Në momentin e fundit, delegacioni shqiptar pajtohet të nënshkruajë një marrëveshje politike, por thekson se në fillim do që të kthehet në shtëpi për konsultime përfundimtare. Pala serbe gjithashtu mbështeti marrëveshjen politike, por vuri në dukje se në momentin e fundit është ndryshuar një marrëveshje ndaj palës shqiptare. Ata vazhdojnë të refuzojnë çdo diskutim mbi aneksin ushtarak, pasi ato përfshijnë praninë e forcave paqeruajtëse nën udhëheqjen e NATO-s në Kosovë. Zëvendësit njoftuan se bisedimet do të vazhdojnë më 15 mars.

**10 mars:** Ambasadorët Hollbruk dhe Hill udhëtojnë në Beograd për të ftuar Millosheviqin që të pranojë marrëveshjen politike të përkohshme mbi Kosovën.

**15 mars:** Bisedimet vazhdojnë në Qendrën Cleber në Paris. Delegacioni shqiptar nënshkruajti marrëveshjen e përkohshme të propozuar në takimet e muajit të kaluar në Rambuje. Presidenti Clinton inkurajon Millosheviqin që të pajtohet me kushtet në mënyrë që t'i shmanget konflikteve të mëtejshme dhe gjakderdhjes.

**18 mars:** Bisedimet e paqes në Paris janë pezulluar, sepse delegacioni serb refuzon të bjerë dakord dhe në fakt lë pozicionet e mëparshme në Rambuje. Ndërkohë, një e treta e forcave të armatosura totale të RFJ-së janë të pranishme në Kosovë.

**19 mars:** Misionit Verifikues në Kosovë u tërhoq.

**20 mars:** Forcat e armatosura jugosllave fillojnë ofensivën, duke laguar mijëra shqiptarë nga shtëpitë dhe fshatrat e tyre, duke djegur njëkohësisht shumë shtëpi.

**21 mars:** Komuniteti ndërkombëtar bënë përpjekjen e fundit diplomatike, duke dërguar ambasadorin Hollbruk në Beograd për t'i dorëzuar Millosheviqit "paralajmërimin përfundimtar".

**22 mars:** NATO i miraton Sekretarit të Përgjithshëm Solanës për të vendosur, pas konsultimeve të mëtejshme, mbi një gamë të gjerë të operacioneve ajrore, nëse është e nevojshme.

**23 mars:** Ambasadori Hollbruk largohet nga Beogradi në mbrëmje, pasi nuk mori asnjë garanci nga Millosheviqi.

**24 mars:** Fillojnë sulmet ajrore të NATO-s. Dhjetëra mijëra kosovarë kanë ikur tashmë për shkak të luftimeve të rënda në mbarë Kosovën.

**25 mars:** Qeveria jugosllave ndërpret marrëdhëniet diplomatike me Shtetet e Bashkuara, Francën, Gjermaninë dhe Mbretërinë e Bashkuar.

**26 e 30 mars:** Vendimet e NATO-s për eskalimin e fushatës ajrore.

**27 mars:** Shqiptarët etnikë të cilët u arratisën ose u dëbuan nga shtëpitë e tyre në Kosovë filluan të venë në Shqipëri dhe Maqedoni. Ndërkohë, Duma ruse miraton rezolutën me të cilën dënon veprimet e NATO-s.

**29 mars:** Është raportuar se refugjatët kalojnë kufirin e Kosovës në një normë prej 4.000 banorësh në orë. Janë rreth 60.000 refugjatë në Shqipëri, gjysma e të cilëve kanë arritur gjatë 48 orëve të fundit.

**30 mars:** Kryeministri rus Primakov, Ministri i punëve të Jashtme Ivanov dhe Ministri i Mbrojtjes Sergejev biseduan me presidentin Millosheviq në Beograd.

**3 prill:** Raketat e NATO-s sulmojnë për herë të parë qendrën e Beogradit dhe shkatërrojnë ministritë e Brendshme të Jugosllavisë dhe Serbisë.

**6 prill:** Sulmet ajrore të NATO-s goditën pjesën rezidenciale të qytetit Aleksinac, duke vrarë pesë persona. RFJ-ja shpall armëpushimin e njëans-hëm që zgjat deri më 11 prill. Beogradi thotë se ushtria dhe policia do të përfundojnë operacionet në Kosovë dhe se qeveria do të negociojë me Rugovën. NATO e refuzon ofertën, ndërsa presidenti francez Shirak e quajti armëpushimin e propozuar të paqëndrueshëm pa marrëveshje politike dhe paketë sigurie.

**10 prill:** RFJ-ja dëbon rreth 2.000 qytetarë të Kosovës nga fshati Vragolje. Beogradi paralajmëron Shqipërinë të mos lejojë sulme "terroriste" nga territori i saj apo rrezikojë eskalimin e luftës. Në bisedë me OSBE-në, Ministri i Jashtëm rus Ivanov tha se forcat për implementim në Kosovë nën udhëheqjen e NATO-s ishin "joreale" dhe kërkoi përfshirje më të madhe të KB-së.

**12 prill:** UNHCR raporton se 309.000 banorë të Kosovës kanë ikur në Shqipëri, dhe deri në atë kohë në Maqedoni kanë qenë 119.380 refugjatë. NATO bombardon trenin e pasagjerëve në Grdeliçka klisurë. Janë gjetur nëntë kufoma të tëra dhe katër pjesë të trupit të njeriut. Të paktën 16 persona u plagosën dhe shumë prej tyre konsiderohen si të humbur.

**14 prill:** Sulmet ajrore të NATO-s goditën konvojin e civilëve të Kosovës në Kosovë. RFJ-ja raporton për 64 të vdekur.

**16 prill:** Eksodi i refugjatëve të Kosovës kthehet në një nivel krizash prej 20.000 në ditë.

**18 prill:** UNHCR-ja raporton për 359.000 refugjatë në Shqipëri dhe 132.700 në Maqedoni deri më sot. Komisari i lartë i KB-së Ogata vlerëson se më shumë se gjysëm milionë qytetarë të Kosovës kanë ikur në vende të tjera që nga fillimi i bombardimeve.

**20 prill:** NATO lejon që patriarku rus Aleksej II të vijë në mënyrë të sigurtë për të vizituar patriarkun serb Pavlen. OSBE-ja raporton se forcat serbe dhe trupat shqiptare kane shkëmbyer zjarrin në përplasjen e parë midis dy ushtrive që nga fillimi i krizës. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Solana drejton përditësimin e planeve të forcave tokësore.

**21 prill:** Është raportuar se të gjitha vendet e BE-së kanë rënë dakord të paraqesin planin e propozuar për të ndaluar dërgimin e produkteve të naftës nga ose përmes shteteve anëtare drejt RFJ-së. Raketat e NATO-s goditën në Beograd rezidencën private të Millosheviqit.

**22 prill:** Vendimi për samitin e NATO-s në Kosovë konfirmon pesë pika dhe shton kushte për pezullimin e bombardimeve. NATO njofton intensifikimin e fushatës ajrore.

**23 prill:** NATO shkatërron ndërtesën e Televizionit shtetëror serb në qendër të Beogradit, duke vrarë të paktën 16 njerëz që në atë kohë nuk ishin evakuuar. RFJ-ja pajtohet të pranojë praninë ushtarake ndërkombëtare në Kosovë pas bisedimeve Çernomirdin - Millosheviq në Beograd.

**24 prill:** Kosova është tema mbizotëruese e 50 vjetorit në samitin e NATO-s në Uashington. Shtetet anëtare shpallin plane për vizitë dhe regjimin e ndërprerjes së arritjes së naftës në RFJ.

**9 qershor:** Në Kumanovë u nënshkruajt marrëveshja ushtarake teknike midis RFJ-së dhe KFOR-it. Ky ishte fundi i bombardimeve të NATO-s, dhe Millosheviqi pranoi të tërhiqte policinë dhe forcat ushtarake nga Kosova.<sup>59</sup>

Sipas të dhënave të Fondit për të Drejtën Humanitare (FDH) dhe Fondit për të Drejtën Humanitare të Kosovës (FDH Kosova), në periudhën prej 24.03. deri më 10.06.1999., gjatë konfliktit të armatosur ndërkombëtar në Kosovë, 9.401 njerëz u vranë, u plagosën ose u zhdukën me forcë, nga të cilat 758 u vranë nga aksionet e NATO-s. Nga numri i përgjithshëm i të vrarëve dhe të zhdukurve, 6.511 janë civilë shqiptarë. Midis tyre, 220 u vranë nga bombat e NATO-s. Gjatë periudhës së lartpërmendur, u vranë 189 serbë dhe jo-shqiptarë të tjerë civilë. Midis tyre janë 26 fëmijë nën moshën 16 vjeç. Gjithsej 46 serbë dhe joshqiptarë të tjerë u vranë në sulmet e forcave të NATO-s, ndërsa për vdekjen ose zhdukjen e 143 serbëve

dhe joshqiptarëve të tjerë përgjegjëse është UÇK-ja.<sup>60</sup>

Menjëherë pas ardhjes së KFOR-it në Kosovë ka pasur djegje të përhapura dhe sistematike dhe plaçkitje të shtëpive të serbëve, romëve dhe pakicave të tjera dhe shkatërrime të kishave dhe manastireve ortodokse. Së bashku me këto shkatërrime, populli ishte gjithashtu në qendër të maltretimit dhe frikësimit me qëllim që të detyroheshin njerëzit të largoheshin nga shtëpitë e tyre. Deri në fund të vitit 2000. 210.000 serbë u zhvendosën nga territori i Kosovës sipas të dhënave të Human Rights Watch-it.<sup>61</sup>

**10 qershor:** Është miratuar Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara nr. 1244, me të cilën është përcaktuar mandati i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara mbi Kosovën.<sup>62</sup>

**11 qershor:** Presidenti rus Jelcin thotë se lidhjet me NATO mbeten të ngrira, pavarësisht pezullimit të bombardimeve të NATO-s, por nuk përjashton përmirësimin. Trupat ruse hyjnë në Jugosllavi nga Bosnja, SHBA-ja thotë se ka premtimin nga Moska se nuk do të hyjnë në Kosovë para NATO-s.

**12 qershor:** Trupat ruse hyjnë në Prishtinë 2 orë përpara se të hyjnë trupat e NATO-s në Kosovë dhe zunë pozicion në aeroport. Ministri i Jashtëm rus, Igor Ivanov, e quajti vendosjen "gabimi të pafat". Trupat britanike të NATO-s hyjnë në Kosovë në agim për të filluar marrjen nën kontroll të tërheqjes së forcave serbe. Në Kosovë hyjnë edhe trupat franceze dhe amerikane.

**13 qershor:** Qindra ushtarë serbë tërhiqen nga Prishtina. Trupat ruse ende qëndrojnë në Aeroportin e Prishtinës dhe refuzojnë të lejojnë trupat britanike dhe franceze të lëvizin në aeroport.

**14 qershor:** Serbët e Kosovës ikin nga Kosova ndërsa refugjatët shqiptarë kthehen. Partia ultranacionaliste Radikale Serbe, e kryesuar nga Zëvendëskryeministri i Serbisë Vojislav Sheshel, doli nga Qeveria e Serbisë. Në Glogoc, në perëndim të Prishtinës, janë gjetur 20.000 refugjatë të uritur dhe të zhvendosur shqiptarë.

**15 qershor:** Trupat ruse që ndajnë kontrollin e aeroportit kryesor në Prishtinë kërkojnë ndihmë nga forcat britanike të NATO-s për furnizim. Forcat paqësore të NATO-s arrestuan pesë ushtarë të dyshuar të UÇK-së gjatë natës pas vrasjes së serbit në Prishtinë. OSBE-ja raporton se afërsisht 2.000 refugjatë kanë filluar të kthehen në Kosovë nga Shqipëria. Mbetjet e të paktën 20 shqiptarëve zbulohen nga paqeruajtësit holandezë në Krushën e Madhe. Trupat italiane gjetën dy varre masive në fshatin Korenicë, pranë qytetit të Pejës në Kosovë. Katër shqiptarë u vranë në Prishtinë. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq raporton se të paktën 33.000 serbë ikën gjatë shtatë ditëve të fundit. Kisha Ortodokse Serbe i bënë thirrje Millosheviqit dhe qeverisë që të japin dorëheqjen. Presidenti i Serbisë, Millan Millutinoviç lëshon vendimin me të cilin refuzohet dorëheqja e Partisë Radikale Serbe nga qeveria e Serbisë.

**16 qershor:** NATO raporton se tërheqja Jugosllave nga Zona 1 (zona që shtrihet nga Prishtina në kufirin jugor të Kosovës) përfundoi kryesisht deri në mesnatë.

**17 qershor:** Një zyrtar britanik vlerëson se forcat serbe vranë më shumë se 10.000 persona gjatë dy muajve të luftës dhe pastrimit etnik.

**18 qershor:** Sekretarja e SHBA-së Olbrajt dhe Sekretari i Mbrojtjes Koen arritën marrëveshje me kolegët e tyre rusë në Helsinki për pjesëmarrjen e Rusisë në Kosovë. Ata vendosin që Rusia nuk do të ketë sektor të veçantë në Kosovë dhe se të gjitha forcat e KFOR-it do të punojnë nën rregulla të përbashkëta të angazhimit. Përveç kësaj, marrëveshja thotë se aeroporti i Prishtinës do të jetë i hapur për të gjithë anëtarët e forcave ndërkombëtare të sigurisë.

**19 qershor:** Në dritën e premtimeve të Forcave Ndërkombëtare të Sigurisë se do të mbrojnë të gjithë qytetarët në Kosovë, Serbia u kërkon ser-

60 Humbjet njerëzore gjatë bombardimeve të NATO-s në RFJ, Fondi për të drejtën humanitare: <http://bit.ly/2fCALMw>;

61 Human Rights Report, sipas urdhërit: Krimet e Luftës në Kosovë, Samizdat B92 (2001), faq.38-39 : <http://bit.ly/2wfbUin>;

62 Rezoluta e KS-së të KB-së nr. 1244: <http://bit.ly/2fz2S2Cr>;

bëve të Kosovës të kthehen në Kosovë. Ekipi mjeko-ligjor britanik gjen shumë prova për krimet e kryera nga serbët në Krushën e Madhe. Janë gjetur 100 trupa. UNHCR vlerëson se më 29 qershor 19.000 shqiptarë të Kosovës u kthyen në Kosovë. NATO paralajmëron se dhjetëra refugjatë janë plagosur nga minat tokësore.

**20 qershor:** Në përputhje me Marrëveshjen Teknike Ushtarake të 9-të Qershorit, forcat serbe tërhiqen plotësisht nga Kosova, ndërsa Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Javier Solana përfundoi zyrtarisht fushatën e bombardimeve të NATO-s në ish-Republikën Jugosllave.

**21 qershor:** Zyrtarët e NATO-s dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) nënshkruajtën marrëveshjen për çarmatim. UNHCR vlerëson se më 21 qershor në Kosovë u kthyen 35.400 refugjatë, ndërsa gjithsej deri në atë datë u kthyen 140.000 refugjatë. Dy ushtarë të KFOR-it dhe dy civilë u vranë duke u përpjekur të shpërthejnë numër të madh bombash thërrmuese të pashpërthyer të NATO-s.

**22 qershor:** NATO dhe UNHCR njoftuan kthimin e organizuar të refugjatëve në Kosovë në fund të qershorit të vitit 1999. Sekretari i Përgjithshëm i KB-së Kofi Anan, njofton se Dominik Vian, guvernatori i Guianës Franceze, do të jetë zëvendësi i përfaqësuesit special të KB-së për Administratën e Përkohshme Civile në Kosovë. Udhëheqësi i UÇK-së Hashim Thaçi shpreh shpresën se UÇK-ja dhe udhëheqësi i moderuar shqiptar, Ibrahim Rugova, do të jenë në gjendje të punojnë së bashku.

**23 qershor:** Me kërkesë të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (TPNJ), qeveria zvicerane ngrin pronën e Milosheviqin dhe katër personave të tjerë të akuzuar për krime lufte. Sondazhi i opinionit publik i kryer në periudhën nga 9 deri në 14 qershor, tregoi se 800 të anketuar anembanë Serbisë, tregoi se popullariteti i Milosheviqit ulet.

**24 qershor:** Parlamenti jugosllav miratoi propozimin e qeverisë për t'i dhënë fund gjendjes së luftës. Solana u bën thirrje serbëve të Kosovës që të qëndrojnë në Kosovë, ku do t'i mbrojnë KFOR-i dhe u bën thirrje shqiptarëve të Kosovës të mos bëjnë hakmarrje, por të punojnë për të krijuar një shoqëri demokratike dhe multietnike.

**25 qershor:** Dhoma e lartë e Parlamentit në Rusi miratoi pjesëmarrjen e Ruisë në KFOR. Mijëra romë kanë braktisur shtëpitë e tyre për shkak të hakmarrjeve të shpeshta të shqiptarëve etnikë, që akuzojnë romët për bashkëpunimin me serbët.

**26 qershor:** RFJ-ja zyrtarisht deklaroi pezullimin e gjendjes së luftës, megjithëse kufizimet më të mëdha për Kosovën mbeten në fuqi përmes parlamentit serb.

**27 qershor:** Fshati Bello Pole, afër Pejës, u plaçkit dhe u dogj. Aeroplanët rus arritën në aeroportin e Prishtinës për të sjellë trupa dhe pajisje shitesë. Forcat gjermane të KFOR-it njoftuan në Prizren orën policore për të ndaluar dhunën me motive etnike.

**28 qershor:** KFOR-i vazhdon të vendoset në tërë Kosovën, trupat e Kosovës tani kanë arritur numrin 23.000. UNHCR-ja fillon kthimin e organizuar të refugjatëve shqiptarë nga Maqedonia në Kosovë.

**29 qershor:** UNHCR-ja vazhdon kthimin e organizuar nga Maqedonia, 370 refugjatë u kthyen në 29 qershor me autobusë të KB-së nga Maqedonia. Deri në këtë datë, gjithsej 447.100 refugjatë u kthyen në Kosovë me iniciativën e tyre. Zyrtarisht, UÇK-ja çarmaton njësitë e saj.

**30 qershor:** KB-ja ndërmerr një hap për rivendosjen e sistemit gjyqësor në Kosovë, duke emëruar tre gjyqtarë të gjykatës së qarkut, dy gjyqtarë hetues dhe katër prokurorë publikë për t'u marrë me çështjet e të arrestuarve nga KFOR-i.

**1 korrik:** Pas dy ditë bisedimesh midis NATO-s dhe Ruisë për modalitetet e detajuara të vendosjes së forcave ushtarake ruse, delegacioni rus kthehet në Moskë për konsultime.

**2 korrik:** Sekretari i Përgjithshëm i KB-së njofton Kryetarin e Këshillit të Sigurimit për qëllimin e tij për të emëruar Bernard Kouchner si përfaqësuesin e tij të posaçëm në krye të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. I dërguari i posaçëm i KB-së Sergio Vieira de Melo, tha se dëshiron që serbët dhe shqiptarët e Kosovës të formojnë një këshill që do të marrë vendime politike në një përpjekje për të zvogëluar dhunën dhe

ulur tensionet në Kosovë. Pas takimit me Melon, liderët shqiptarë dhe serbë të Kosovës lëshojnë një deklaratë të përbashkët për përfundimin e dhunës në Kosovë.

**6 korrik:** Në Leskoc, lind një protestë spontane kundër regjimit të Slllobodan Millosheviqin, pas një thirrjeje nga redaktorët televizivë kundër autoriteteve lokale. Është raportuar se rreth 20.000 persona u bashkuan me protestën. Bisedimet në Moskë nga 4 deri më 5 korrik midis NATO-s dhe Ruisë zgjidhën detajet teknike ushtarake mbi pjesëmarrjen e Ruisë në KFOR, veçanërisht për vendosjen e saktë, rregullimet e komandës dhe rregullat e angazhimit. Përfunduan punët për rikonstruksionin dhe instalimin e pajisjeve në aeroportin e Prishtinës.

**7 korrik:** Fillojnë demonstratat kundër regjimit të Slllobodan Millosheviqit në Nish. Demonstruesit mbledhin firmat për një peticion, duke i bërë thirrje Millosheviqit që të japë dorëheqjen. Po ashtu protestohet në Leskoc, si dhe në Uzhice, ku Aleanca për ndryshim bëri për vete më shumë se 5.000 persona. UNHCR-ja organizon kthimin e 407 refugjatëve nga Mali i Zi.

**8 korrik:** Rreth 2.500 policë civilë janë zotuar të punojnë në policinë civile të KB-së. Partia Demokratike, e cila ka 31 nga 110 vende në Kuvendin e qytetit të Beogradit, i bën thirrje Millosheviqit të japë dorëheqjen.

**12 korrik:** Prokurorja e TPNJ-së Arbur shpreh bindjen se dëgjimi i Millosheviqit është një qëllim shumë realist. Masa e protestuesve kundër Millosheviqit sulmoi selinë e Partisë Socialiste në Valevë. Përfaqësues nga shumë vende ku gjenden refugjatë nga Kosova, si dhe UNHCR-ja dhe Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM), takohen në Gjenevë dhe pranojnë udhëzimet e UNHCR-së për kthimin vullnetar.

**14 korrik:** Prokurorja e KB-së për krimet e luftës, Louis Arbur, vizitoi varret masive në Kosovë. Me këtë rast, ajo deklaroi: "Çdo hap që bëjmë, çdo varr që zbulojmë, çdo aktakuzë që sjellim është një hap i pakthyeshëm drejt afrimit të të akuzuarve në drejtësi". David Govan, Koordinator për Krimet e Luftës në Ministrinë Britanike të Punëve të Jashtme, konfirmoi vlerësimet e mëparshme të qeverisë britanike se të paktën 10.000 shqiptarë të Kosovës janë vrarë në krimet e spastrimit etnik.

**15 korrik:** Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së, Bernard Kouchner, arrin në Kosovë. Kouchner u bënë thirrje serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës të ecin drejt "paqes dhe pajtimit, në mënyrë që njerëzit të bisedojnë me njëri-tjetrin dhe të ndërtojnë demokraci".

**16 korrik:** Takimi i parë i Këshillit të Përkohshëm të Kosovës u mbajt me Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së Kushnerin. Ky këshill mbledh të gjitha bashkësitë etnike në Kosovë dhe shërben si ndërmjetës me zyrtarët e KB-së. Ibrahim Rugova nuk mori pjesë në takim. UNHCR-ja njofton se mbrojtja e serbëve në Kosovë është tani "çështja më e rëndësishme". Vlerësimet e KB-së tregojnë se rreth 146.000 serbë u larguan nga Kosova në drejtim të Serbisë. UNHCR-ja vlerëson se deri në atë kohë 662.000 refugjatë u kthyen në Kosovë. Gjatë javës, UNHCR-ja, me ndihmën e agjencisë gjermane THW, shpërndau 2.000 komplete për strehime emergjente në zonën e Rahovecit dhe planifikon të shpërndajë edhe 16.000 komplete të tjera.

**17 korrik:** OSBE-ja fillon rekrutimin për forcat e reja të policisë së Kosovës.

**19 korrik:** Kancelari gjerman Gerhard Schroeder u takua me kreun e opozitës serbe Zoran Gjingjiq, dhe pas kësaj kancelari Shreder i premtoi opozitës serbe mbështetjen e vet. Kancelari Shreder thotë: "Gjermania mbështet opozitën dhe ka interes për të gjithë Evropën që demokracia të vijë në Jugosllavi - një demokraci pa Milosheviqin". Në Serbinë qëndrore, Vuk Drashkoviq, kreu i Lëvizjes për Ripërtëritjen Serbe, filloi fushatën për zgjedhje të parakohshme, duke deklaruar se erdhi koha t'i jepet fundi qeverisë së Millosheviqit. Sipas raporteve të mediave, prioriteti kryesor i tij është krijimi i një qeverie kalimtare nën Millosheviqin për t'i dhënë fund sanksioneve. Ai gjithashtu kërkon që Millosheviqit t'i jepet imunitet nga arrestimi ose ekstradimi.

**22 korrik:** Ish shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, Momçillo Perishiç bën thirrje për heqjen paqësore të regjimit të Millosheviqit nga pushteti. Mesnata e 21 korrikut ishte afati i fundit për forcat e UÇK-së për të dorëzuar të gjitha armët e ndaluara dhe 30% të armëve automatike në vendet e sigurisë. Komandanti i KFOR-it gjenerali Jackson tha se ai është "i inkurajuar nga sasia e armëve që u dorëzuan gjatë ditëve të fundit".

**23 korrik:** Katërmbëdhjetë fermerë serbë u vranë në Kosovë në fshatin Staro Gracko (Grackë e Vjetër). Zëdhënësi i KFOR-it tha se "KFOR-i dhe policia ndërkombëtare do të kapin ata që janë përgjegjës për këtë krim të tmerrshëm. Ne do të përpiqemi që ata të sillen para drejtësisë për t'u përballuar me fuqinë e plotë të ligjit". Pesë shqiptarë etnikë u arrestuan pas shkëmbimit të zjarrit me trupat e KFOR-it në Kosovën perëndimore. UNHCR-ja vlerëson se deri në 23 korrik 720.700 refugjatë janë kthyer në Kosovë. Qendra e KB-së për Koordinimin e Veprimit ndaj Minave bëhet operative në Prishtinë, dhe shërben si një qendër për planifikimin dhe koordinimin e operacioneve të lidhura me minat dhe sendet e pashpërt-hyera vdekjeprurëse në Kosovë.

**24 korrik:** Kryeprokurorja e KB-së Luiz Arbur, tha më 23 korrik se ajo nisi hetimin për vrasjen e 14 serbëve nga Staro Gracko. Rreth 260 serbë u kthyen në Kosovë nga territori i Beogradit dhe Kralevsës. Të shoqëruar nga ushtarë të KFOR-it, serbët u nisën në Fushë Kosovë.

**26 korrik:** Një grup rezervistësh i Ushtrisë Jugosllave në Nish fillon një grevë urie në shenjë proteste për pagat e papaguara. UNHCR-ja vlerëson se deri më 26 korrik 727.000 refugjatë u kthyen në Kosovë. UNHCR-ja publikon një raport duke përdorur të dhënat e mbledhura nga 456 fshatra të prekura nga lufta. Raporti tregon se 54% e shtëpive në këto fshatra kanë pësuar dëme serioze ose shkatërrim total.

**28 korrik:** Radio Prishtina fillon transmetimin në gjuhën shqipe, serbo-kroate dhe turke nën mbikëqyrjen e OSBE-së. Donatorët premtajnë 2.082 miliardë dollarë për të ndihmuar Kosovën në një konferencë donatorësh në Bruksel. SHBA-ja premtton 556 milionë dollarë për ndihmë humanitare shtesë dhe ndihmë jo-humanitare urgjente për Kosovën, nga buxheti plotësues i miratuar nga Kongresi dhe nënshkruar më 21 maj 1999. UNHCR-ja vlerëson se 734.000 refugjatë janë kthyer në Kosovë deri në 28 korrik.

**29 korrik:** KFOR-i njofton se tre shqiptarë etnikë janë arrestuar për hetim për vrasjen e 14 korrësve serbë në Staro Gracko.

**30 korrik:** Liderët e botës takohen në Sarajevë në Samitin e Paktit të Stabilitetit. Presidenti i SHBA-së Klinton njofton se do të punojë me Kongresin dhe do të sigurojë 10 milionë dollarë për forcimin e mediave të pavarura, organizatave joqeveritare, sindikatave të pavarura dhe opozitës demokratike në Serbi. Ibrahim Rugova kthehet në Kosovë.

**31 korrik:** Ushtarët rusë të KFOR-it ndalën gjeneralin e UÇK-së Agim Çekun. Që nga 31 korriku, UNHCR-ja dërgoi 13.000 çadra në Kosovë. Është vlerësuar se 10.000 shtëpi u dëmtuan gjatë luftës.

**1 gusht:** Shpërthimi i një bombe në një kishë ortodokse të papërfunduar në Prishtinë. Nuk pati viktima.

**2 gusht:** Sipas raporteve të UNHCR-së nga terreni, në Malin e Zi po qëndrojnë edhe 23.000 jo-shqiptarë nga Kosova. UNHCR-ja vlerëson se deri më 2 gusht, 743.300 refugjatë janë kthyer në Kosovë. Studentët dhe mësuesit kthehen në Universitetin e Prishtinës.

**3 gusht:** Human Rights Watch publikon një raport për shkeljet e të drejtave të njeriut pas 10 të qershorit drejtuar drejt popullsisë serbe dhe romë në Kosovë. Raporti sugjeron përfshirje më të madhe të forcave ndërkombëtare policore, kthimin e të shpërngulurve, procesuimin e të gjitha sulmeve si dhe rekomandimet drejtuar UÇK-së për të "ndërmarrë veprime të shpejta dhe të vendosura" për të parandaluar krime të mëtejshme kundër serbëve dhe romëve.<sup>63</sup>

**4 gusht:** NATO emëron Ministrin britanik të Mbrojtjes, George Robertson, sekretar të përgjithshëm. UNHCR-ja vlerëson se pothuajse 90% e mbi 850.000 shqiptarëve që u larguan nga Kosova gjatë luftës, u kthyen në krahinë.

**6 gusht:** Ibrahim Rugova bashkohet me Këshillin kalimtar të Kosovës.

## Rënia e Millosheviqit dhe Qeveria e parë demokratike e Serbisë

### 2000-2003.

**5 tetor 2000:** Në zgjedhjet e 24 shtatorit, Vojislav Koshtunica, kandidat i kualicionit DOS (ODS), fitoi Millosheviqin në zgjedhjet presidenciale. Pas protestave të mëdha për shkak të vjedhjes elektorale, Millosheviqi zbret nga pushteti.

**nëntor 2000:** Pas përfundimit të luftës në Kosovë, konfliktet me intensitet të ulët u derdhën në territorin e komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Pas një kohe të shkurtër heshtjeje, shqiptarët nga jugu i Serbisë ri-aktualizojnë qëllimin e tyre që e ashtuquajtura Luginë e Preshevës të bashkohet me Kosovën, gjë që u shpreh për herë të parë në një referendum jozyrtar të mbajtur në vitin 1992. Kriza intensifikohet në nëntor të vitit 2000 kur Ushtria Çlirimtare e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit (UÇPMB) intensifikon sulmet ndaj forcave të sigurisë të RF të Jugosllavisë dhe Serbisë.<sup>64</sup>

**25 janar 2001:** Zoran Gjingjiq zgjidhet Kryeministër i Serbisë.

**12 mart 2001:** Kriza në Serbinë jugore përfundoi me nënshkrimin e dy marrëveshjeve të veçanta për armëpushim: njëra midis Serbisë dhe përfaqësuesve të KFOR-it në Merdare dhe tjetra ndërmjet UÇPMB-së dhe të dërguarit special të NATO-s në Konçul. Mirëmbajtja e marrëveshjes parashikohet me "Programin për zgjidhjen paqësore të krizës në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë", të cilin në emër të Qeverisë së Serbisë e hartoi zëvendëskryetari i saj Nebojsa Çović. 29 Elementet kyçe të "planit të Çovićit" ishin: shpërbërja, çarmatimi dhe amnestia e anëtarëve të UÇPMB-së; tërheqja e forcave të jashtëzakonshme ushtarake dhe policore; kthimi i refugjatëve; ndërtimi i institucioneve multietnike dhe respektimi i të drejtave të njeriut dhe ringjallja ekonomike e këtyre tri komunave.<sup>65</sup>

**1. prilli 2001:** U arrestua Slobodan Millosheviq.

**3 maj 2001:** MPB-ja e Serbisë pensionon tani ish shefin e RSP-së Vllastimir Gjorgjeviq, duke mohuar se kjo ka të bëjë me "çështjen e frigoriferit"

**7 maj 2001:** Kryeshefi i RSP-së Sreten Lukiq formon një grup operacional të ngarkuar me vërtetimin e të gjitha fakteve relevante rreth gjetjes së një kamioni në të cilin janë gjetur trupa të paidentifikuar dhe për të marrë masat e duhura ligjore në bazë të rezultateve.

**18 maj 2001:** Zëvendëskryeministri serb Zharko Koraq në Gjenevë deklaroi se "Qeveria po punon shumë me qëllim që aktakuza vendase kundër ish presidentit jugosllav Slobodan Millosheviq të zgjerohet edhe për krime lufte".

**19 maj 2001:** Ministri i Drejtësisë Vlladan Batiq kërkon nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Serbisë, dhe z.d. prokurori publik i republikës të sqarohet "rasti i frigoriferit".

**23 maj:** Natasha Kandiq (Fondi për të drejtën humanitare) lajmëron me shkrim ministrat e Drejtësisë dhe Policisë dhe Kryetarin e Kuvendit të Serbisë se në liqenin në Kokin Brod gjendet kamioni me kufoma nga periudha e bombardimit të NATO-s.

**24 maj 2001:** Ministri i Policisë Dushan Mihajloviq shpjegon se Sreten Lukiq (nga qershori i 1998-ës deri në fund të bombardimeve të NATO-s në 1999, në pozitën e koordinatorit të shtabit të MPB-së të Serbisë për Kosovën dhe Metohinë dhe më vonë i dënua me 20 vjet burg për krime në Kosovë) u vendos në pozitën e kryeshefit të RSP-së, dhe "sepse dosja e tij është e pastër dhe se ai nuk mund të përgjigjet për krimet e kryera në Kosovë vetëm sipas përgjegjësisë së komandës". Kryeministri Zoran Gjingjiq thotë se anëtarët e Qeverisë ishin të vetëdijshëm se Sreten Lukiq "nuk është ëngjëll", por se ai ishte më i përshtatshmi nga të gjithë kandidatët.

**25 maj 2001:** Kapiteni i policisë, Dragan Karleusha, njofton se heqja e gjurmëve të krimeve nga Kosova dhe Metohia është bërë me urdhër të

64 Marija Marović, Filip Ejduš, Ivan Kostiq, Perceptimi i sigurisë në jug të Serbisë, Qendra Ballkanike për Lindjen e Afërme, dhjetor 2012, faq. 16 : <http://bit.ly/2w400qD>;

65 Njësoj, faq. 16-17: <http://bit.ly/2w400qD>;



Sllobodan Millosheviqit, të lëshuar në mes të marsit 1999 në një takim ku morën pjesë Ministri i atëhershëm i Brendshëm Vllajko Stojilkoviq, pastaj ish kryeshefi i RSP-së gjenerali Vllastimir Gjorgjeviq, pastaj kryeshefi i atëhershëm i RSSH-së gjenerali Radomir Markoviq dhe të tjerë.

**2 qershor 2001:** Në prag të Ditës së re të Policisë (më parë ka qënë 13 maji, sipas të cilës edhe quhet baza e NJSA-së në Batajnicë), ministri i policisë Dushan Mihajloviq njofton se ka filluar zhvarrosja e një varri, por përsërit se në territorin e Serbisë ka më shumë varre masive. Thuhet se në frigoriferin e nxjerë të Tekia ka pasur 83 trupa dhe tre koka pa trupa.

**7 qershor 2001:** Javorja "Vreme", publikon se varri masiv ku filloi zhvarrosja gjendet në terrenet e poligonit të trajnimit të Njësisë Speciale Antiterroriste (NJSA) të MPB-së së Serbisë "13. maj" pranë Batajnicës. MPB-ja e Serbisë më vonë konfirmon informacionin e javores "Vreme", si dhe atë të botuar më parë, se në Petrovo Selo, gjithashtu të poligoni i NJSA-së, ka edhe varre të tjera masive.

**15 qershor 2001:** Ministri Dushan Mihajloviq dhe MPB-ja e Serbisë konfirmojnë se të dhënat operative tregojnë disa varre masive në Serbi, në të cilat mund të jenë të varrosur të paktën 800 njerëz. "Vreme" (nr. 546 nga data 21 qershor) publikon një histori dramatike të një shofer kamioni me kufoma, i cili ndërkohë ka gjetur një strehë jashtë vendit, ndërsa "Timoçka Krimi Revija" informacionin se një shofer kamioni, që e njohin ata, gjatë bombardimeve të NATO-s nga Kosova dhe Metohia ka transportuar rreth një mijë kufoma.

**28 qershor 2001:** Sllobodan Millosheviq iu ekstradua TPNJ/ICTY në Hagë. Gjithmonë përgjegjës, kurrë i dënuar, Millosheviq është kreu i parë i një shteti i ngarkuar për:

... gjenocid; bashkëpunim në gjenocid; dëbim; vrasje; përndjekje politike, racore ose fetare; veprime çnjerëzore/zhvendosje me forcë, shfarosje; burgosje; torturë; vrasje të qëllimshme; burgosje të paligjshme; shkaktim të vuajtjes së madhe të qëllimshme; dëbim apo zhvendosje të qëllimshme; shkatërrim të gjerë dhe përvetësim të pronës, e pajustificuar nga domosdoshmëria ushtarake dhe e kryer në mënyrë joligjore dhe pa arsye; trajtim mizor; plaçkitje të pronës publike ose private; sulme ndaj civilëve; shkatërrim ose dëmtim të qëllimshëm të monumenteve historike dhe institucioneve arsimore ose fetare; sulme të paligjshme mbi objekte civile; shkaktim të qëllimshëm të vuajtjes së madhe.<sup>66</sup>

**Korrik - gusht 2001:** Zhvarrosja e dy varreve masive në Petrovo Selo dhe një në Batajnicë kanë nxjerrë së paku kufomat e të paktën 110 personave. Ndryshe nga Petrovo Selo, ku nga 74 u vërtetua vetëm një kufomë femre, në Batajnicë janë zhvarrosur të mbeturat e tetë fëmijëve dhe një fetus, të tjerët ishin femra dhe burra. U gjetën dokumentat e gjashtë personave me mbiemër Berisha, të gjithë nga Suhareka.

**Shtator 2001:** Zhvarrimi i një varri masiv pranë liqenit Peruqac pranë Bajina Bashtës ka zbuluar mbetjet e të paktën 48 burrave të rritur. Në varrin e dytë në Batajnicë, u zbuluan të paktën të mbeturat e 269 burrave, së bashku me rimorkionin e kamionit në të cilin janë sjellë.<sup>67</sup>

**12 mars 2003:** U vra Zoran Gjingjiq, Kryetari i parë demokratik i Qeverisë së Serbisë.

## Dhuna e Marsit

### 2004.

Dhunës më motive etnike në Kosovë, të drejtuar ndaj komunitetit serb, i paraprinë një sërë incidentesh të vogla. Në fillim, më 15 mars, në Çaglavicë, pranë Prishtinës, është plagosur një djalë, Jovica Iviq, i cili në gjendje të rëndë u transferua në spital në Mitrovicën e Veriut. Pastaj u bë një

66 Çështja IT-02-54 para TPNJ/ICTY: <http://bit.ly/2fd317Q>;

67 Kronologjia e ngjarjeve nga maji deri në shtator të vitit 2001 marrë sipas tekstit të Aleksandar Qiriqit "Arkeologjia e Batajnicës" (VREME, nr. 618/7. nëntor i vitit 2002): <http://bit.ly/2w05RKv>;

protestë e fshatarëve të këtij fshati, si dhe të fshatrave të tjera serbe në afërsi (Graçanicë, Sushicë, Llapllasellë, Preoc ...). Pas kësaj ngjarjeje dhe kontrollimit në Çagllavicë nga ushtarët e KFOR-it, një grup qytetarësh i kombësisë serbe bllokoj rrugët kryesore drejt Shkupit dhe Gjilanit, duke patur incidente me shqiptarët vendas.<sup>68</sup>

Në mes të marsit, në disa qytete të Kosovës, shoqatat e veteranëve të UÇK-së organizuan protesta kundër arrestimit të komandantit të Degës së Trupave Mbrojtëse të Kosovës (forma e mëhershme e Forcave të Sigurisë së Kosovës) në Prizren, Selim Krasniqit dhe disa prej oficerëve të tij. Në këto protesta, organizatorët e kanë kritikuar ashpër politikën e UNMIK-ut ndaj UÇK-së, duke kërkuar lirim të ish luftëtarëve të UÇK-së.<sup>69</sup>

Tre djemë shqiptarë, Floriani (9), Egzoni (12) dhe Avni Veseli (13), nga fshati Çabré në komunën serbe të Zubin Potokut, u mbytën në lumin Ibër pafundësi më 16 mars. Djali i katërt, Fitim Veseli (11), ka arritur të dalë në breg. Trupat e dy djemëve u gjetën gjatë natës në lumë. Djaloshi i mbijetuar dha një deklaratë se atë dhe tre shokët e tij i kanë ndjekur serbët me qenë, dhe prandaj kërkuan shpëtim në lumë. Deklaratën e tij gjatë natës dhe mëngjesit të ardhshëm e transmetuan të gjitha televizionet kosovare, duke përforcuar akuzat kundër serbëve me komentet e disa figurave publike se „me rastin e krimeve serbe duhet të bëhet diçka“. Një lajm i tillë, mëngjesin e ardhshëm, përkatësisht më 17 mars, u bë shkaktari i dhunës shumë-ditore kundër komunitetit serb në Kosovë.<sup>70</sup>

Sipas raportit të Fondit për të Drejtën Humanitare që merret me dhunën etnike që ndodhi në Kosovë më 17 dhe 18 mars të vitit 2004, u vranë 15 shqiptarë dhe 12 serbë. Rreth 170 serbë u plagosën rëndë, nga të cilët 150 me rrahje në shtëpitë e tyre, ndërsa 20 u plagosën në sulme nëpër rrugë. Sa i përket objekteve, rreth shtëpi 800 serbe, 90 të ashkalinjëve dhe dy shqiptarë janë shkatërruar plotësisht ose janë dëmtuar seriozisht. Përveç objekteve civile, 36 ndërtesa fetare ortodokse u shkatërruan plotësisht dhe u dogjën. Sipas raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së, në dhunën e marsit 954 persona u plagosën, duke përfshirë 65 policë ndërkombëtarë, 58 oficerë të SHPK-së dhe 61 anëtarë të forcave paqeruajtëse ndërkombëtare.<sup>71</sup>

Ekzistojnë shkaqe për të konkluduar se demonstratat me rastin e fatit tragjik të tre djemve shqiptarë u organizuan në mënyrë të organizuar në dhunën kundër serbëve, kulturave dhe feve të tyre dhe frikësimit të UNMIK-ut. Aty ku përfaqësuesit e pushtetit u përpoqën të qetësojnë demonstruesit, ndodhi që edhe ata gjithashtu u bënë objekt i sulmit, si në Kamenicë. Ekziston gjithashtu një bazë për përfundimin se heshtja e përfaqësuesve të institucioneve dhe udhëheqësve të partive politike më 17 mars i inkurajoi organizatorët dhe demonstruesit të intensifikojnë dhunën më 18 mars. Drejtimi i tyre publikut dhe thirrja për t'i dhënë fund dhunës u dukën jo të sinqerta dhe të detyruara.<sup>72</sup>

Pastaj pasoi reagimi i dhunshëm anembanë qyteteve të Serbisë. Natën e 17/18 marsit, mbledhja e qytetarëve filloi pa incidente, por në një moment një grup prej rreth 800 të rinjëve u nda dhe u drejtua drejt Bajrakli xhamisë, xhamisë së vetme në Beograd. Në natën midis 17 dhe 18 marsit të vitit 2004, xhamia u dogj.

Në përlëshjet e policisë dhe demonstruesve atë natë, 20 policë u plagosën, tre prej të cilëve rëndë. Pas mesnate, një grup me rreth 100 demonstrues arriti të thyejë kordonin e policisë në cep të rrugëve Kralja Petra e Gospodar Jevremova. Pasi policia u tërhoq nga rruga Jevremova, demonstruesit thyen dritaret dhe sendet brenda xhamisë, pastaj e dogjën, dhe të gjitha këto u shoqëruan me klithmat e gjuhës së urrejtjes, të tilla si "Vra shqiptarin", "Vra, therr, që shqiptari të mos egzistojë" dhe "Shkojmë në Kosovë". Dëmi material ishte i madh, por u dogj edhe biblioteka me më shumë se 7.000 libra, gjë që është e vështirë të shprehet në vlerën materiale. Policia me gaz lotsjellës dhe granata mpirëse, rreth orës 3 e 45 minuta pas mesnate arriti të shpërndajë demonstruesit, disa prej të cilëve ishin të dehur dukshëm. U arrestuan gjithsej 83 persona të lidhur me incidentet. Ka pasur edhe disa incidente të lidhura të njëjtën natë në Beograd, ndër të cilat ishin trazirat para ambasadës së SHBA-së, thyerrja vandale e xhamave të dritareve të ndërtesës së McDonalds-it në Terazije dhe dy dyqane në Zeleni Venac pronarët e të cilave janë shqiptarë, dhe sulmi në dy xhipa të UNHCR-së. Me thyerjen e dritareve të dyqaneve dhe sulmeve ndaj lagjeve rome, atëherë u dogj edhe xhamia e Islam - agës

68 B92 Special: Dhuna në Kosovë (16-22. mars 2004.), Sajt B92: <http://bit.ly/2y398xk>;

69 Fondi për të drejtën humanitare, Mars 2004: Dhuna etnike në Kosovë, faq. 4: <http://bit.ly/2567gMh>;

70 Njësoj, faq. 4: <http://bit.ly/2567gMh>;

71 Njësoj, faq. 4: <http://bit.ly/2567gMh>;

72 Njësoj, faq. 3: <http://bit.ly/2567gMh>;

në Nish. Në të njëjtin rast, në Muzeun Ushtarak në Beograd u shkatërruan monumentet myslimanë nga shekulli i 16-të, por kundër autorëve në muze kurrë nuk është nisur hetimi.

Shtatëmbëdhjetë marsi i vitit 2004 u shënua edhe me një protestë të organizuar nga Qeveria e Serbisë më 19 mars, lidhur me dhunën e kryer kundër serbëve në Kosovë. Në protestë folën kryeministri i atëhershëm Vojislav Koshtunica, anëtarët e Qeverisë dhe zyrtarë të Kishës Ortodokse Serbe. Shumica e demonstruesve ishin nxënës të shkollave të mesme, të cilët erdhën të organizuar në protest pas orës së hapur publike në shkolla. Mediat atë ditë ndërpreën programin tre minuta në orën 12:00, si shenjë kujtimi për të vrarët.

Pas procesit ankimor për rrëmujën pas 17 marsit, Gjykata e Apelit në Beograd në shkurt të vitit 2014 konfirmoi dënimet nga procesi maratonik i shkallës së parë (shtator 2007 - korrik 2013) me nga katër muaj burg për Milosh Radisavleviq, Radeta Radisavleviq dhe Bojan Hrvatina për shkak të gjuajtjes me gurë të kordonit të policisë që ka ruajtur Bajrakli xhaminë. Gjithashtu, janë konfirmuar edhe aktgjykimet liruese për Borisav Mitrasheviq, Stefan Radeviq, Goran Mitiq dhe Nikola Marinkoviq, ndërsa për Stefan Çubroviqin dhe Vladan Broqiqin është urdhëruar rigjykimi.<sup>73</sup>

Sasha Cvjetan, anëtar i përbërjes rezervë i Njësisë Speciale Anti-terroriste "Shkorpionët", u dënua më 17 mars të vitit 2004 me 20 vjet burg për krime lufte të kryera kundër civilëve shqiptarë në Podujevë, më 28 mars të vitit 1999. Cvjetan u dënua për vrasjen e katërmëdhjetë grave dhe fëmijëve, si dhe plagosjen e pesë fëmijëve, ku morën pjesë edhe disa njerëz. Atëherë u vranë Shefkate, Nora, Sala, Shpendi, Shpëtimi dhe Shehida Bogujevci, Ferzi dhe Nefis Llughaliu, Ismeti, Fikreta, Dafina, Arbëri, Mimoza dhe Albion Duriqi. Janë plagosur rëndë Saranda, Fatos, Jehona, Liria dhe Genc Bogujevci.<sup>74</sup>

## Negociatat në Vjenë

### 2005 - 2007.

#### 2005.

**11 nëntor:** KS i KB-së emëroi ish-presidentin e Finlandës Marti Ahtisarin për të dërguarin e KB-së në negociata.

#### 2006.

janar: Në janar Grupi i Kontaktit për Kosovën caktoi udhëzimet për negociata dhe morri qëndrimin se nuk mund të ketë kthim në gjendjen para vitit 1999, as ndarje të Kosovës, dhe as bashkim të saj me ndonjë vend të tretë.

**20 shkurt:** Në Vjenë fillojnë zyrtarisht negociatat e drejtpërdrejta midis Beogradit dhe Prishtinës. Tema e diskutimit është decentralizimi i pushtetit në Kosovë dhe transferimi i përgjegjësive nga disa fusha të jetës së përditshme. Bisedimet kanë përfunduar pa ndonjë marrëveshje konkrete.

**17 mars:** Në takimin e dy delegacioneve, u diskutua për financimin e komunave serbe dhe ndërlidhjen e tyre me autoritetet në Serbinë qëndrore, për të cilën janë shprehur qëndrime të ndryshme.

**3 prill:** Zyra e të Dërguarit Special të KB-së Marti Ahtisarit, bëri një dokument që duhej të ndihmonte që të afroreshin dy palët në këtë takim të tretë, por asnjë marrëveshje konkrete nuk u arrit.

**4 e 5 maj:** Në takim u diskutua për formimin e komunave të reja në Kosovë. Beogradi dhe Prishtina nuk arritën kompromis, kështu që u njoftua puna e mëtejshme me ekspertë për çështjet e diskutueshme.

<sup>73</sup> Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut, Zbatimi i standardeve të gjykimet të drejtë në sistemin gjyqësor të Serbisë (2015): Çështja e djegjes së Bajrakli xhamisë, faq. 108-111; <http://bit.ly/1H8iN5j>;

<sup>74</sup> Çështja Podujevo II para Departamentit për krime të luftës në Beograd, faq. 5-6: <http://bit.ly/2fb2qtG> ;

**23 maj:** Raundi i pestë i negociatave, i përkushtuar mbrojtjes së trashëgimisë fetare dhe kulturore të Kosovës, është vlerësuar si i dobishëm. Delegacionet ranë dakord se mbrojtja fizike e monumenteve kulturore dhe fetare ishte e nevojshme, por kishte dallime në konceptet e mbrojtjes.

**31 maj:** Cikli i parë i negociatave të drejtpërdrejta për statusin përfunduan në raundin e gjashtë të negociatave për çështjet ekonomike, që u vlerësua si më i vështiri deri atëherë.

**13 korrik:** Marti Ahtisari njoftoi anëtarët e Këshillit të Sigurimit të KB-së për rrjedhën e negociatave dhe për synimin e tij për të mbajtur një takim politik në nivel të lartë.

**24 korrik:** Në Vjenë u mbajtën negociatat e para të drejtpërdrejta të zyrtarëve më të lartë të qeverive për statusin e Kosovës, të udhëhequr nga Marti Ahtisaari. Presidenti serb Boris Tadiq dhe Kryeministri Vojislav Koshtunica morrën qëndrim për autonominë e gjerë të Kosovës si një zgjidhje kompromisi për statusin e ardhshëm të krahinës, ndërsa zyrtarët e Kosovës, Fatmir Sejdiu dhe Agim Çeku, për pavarësinë dhe që Kosova të bëhet shtet sa më shpejt.

**7 e 8 gusht:** Në raundin e tetë të negociatave, të dy palët mbetën në pozitat fillestare mbi juridiksionin e komunave të reja me shumicë serbe por edhe bisedimet për të drejtat e minoriteteve përfunduan pa përparim.

**7 e 8 shtator:** Temat kryesore të raundit të tetë të negociatave ishin formimi i komunave të reja në Kosovë dhe çështja e Mitrovicës së Kosovës, si dhe mbrojtja e kishave dhe manastireve dhe mbrojtja e të drejtave të pakicave kombëtare. As në këtë takim nuk u arrit progres i madh.

**15 shtator:** Raundi i dhjetë i negociatave, ku vazhdoi debati mbi decentralizimin, nuk dha rezultate të rëndësishme.

**20 shtator:** Grupi i Kontaktit ka mandatuar kryenegociatorin, Marti Ahtisarin, për të nisur hartimin e një zgjidhjeje gjithëpërfshirëse për statusin e Kosovës.

**19 tetor:** KB-ja zgjati mandatin e të dërguarit special të tyre për negociatat për statusin e Kosovës deri në qershor të vitit 2007. Njoftimi i propozimit për zgjidhjen e Kosovës, të paraparë për fundin e vitit 2006, u shty deri në shkurtin e vitit 2007, për shkak të zgjedhjeve parlamentare në Serbi.

## **2007.**

**2 shkurt:** Marti Ahtisari në Beograd dhe Prishtinë paraqiti propozimin e zgjidhjes të statusit të Kosovës ku nuk përmend "pavarësinë", por në bazë të së cilës Kosova do të ketë atributet e një shteti të pavarur dhe qasje në organizatat ndërkombëtare.

**13 shkurt:** Kuvendi i Serbisë miratoi një rezolutë me të cilën refuzohen të gjitha propozimet e Ahtisarit që "shkelin sovranitetin dhe integritetin territorial të Serbisë si shtet të njohur ndërkombëtarisht".

**21 shkurt - 2 mars:** Në Vjenë u mbajt raundi i parë i negociatave përfundimtare ndërmjet përfaqësuesve të Beogradit dhe Prishtinës mbi statusin e propozuar të të dërguarit të posaçëm të KB-së për Kosovën Marti Ahtisari, në të cilin nuk kishte konvergencë mbi statusin e Kosovës.

**10 mars:** Raundi i fundit i negociatave rreth propozimit të të dërguarit të posaçëm në Vjenë u përfundua pa marrëveshje.

**3 prill:** Në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të KB-së, Marti Ahtisari paraqiti propozimin e tij të zgjidhjes (i njohur si plani i Ahtisarit)<sup>75</sup> për statusin e Kosovës që parasheh pavarësinë e Kosovës me mbikëqyrjen ndërkombëtare. Kryeministri i Serbisë ka kërkuar nga Këshilli i Sigurimit të hedhë poshtë propozimin e Ahtisarit dhe kërkoj negociata të reja për statusin me një ndërmjetësues të ri ndërkombëtar. Pas kundërshtimit të Ruisë për të miratuar rezolutën mbi pavarësinë e mbikëqyrur të Kosovës, Këshilli i Sigurimit i KB-së vendosi t'ia lërë negociatat Grupit të Kontaktit, i cili caktoi tre ndërmjetësues për bisedime të reja. Para fillimit të bisedimeve të drejtpërdrejta, u mbajtën dy takime të veçanta të "Trojkës", me delegacionin e Beogradit dhe Prishtinës, në Vjenë, më 31 gusht dhe në Londër më 18 dhe 19 shtator, ku delegacioni i Prishtinës i dorëzoi "Treshes" ndërmjetësuese propozim marrëveshjen për marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë midis Serbisë dhe Kosovës si shtete të pavarura.

**28 shtator:** Në zyrën e BE pranë KB-së në Nju Jork, filluan negociatat e drejtpërdrejta midis delegacioneve të Beogradit dhe Prishtinës, të udhëhequra nga presidentët dhe kryeministrat e Serbisë dhe Kosovës. Beogradi shpjegoi vizionin e vet të autonomisë substanciale brenda kufijve të Serbisë, ndërsa Prishtina ofroi "miqësinë dhe bashkëpunimin e dy shteteve të pavarura". Të dy delegacionet miratuan Deklaratën e Nju Jorkut, me të cilën ranë dakord se gjatë negociatave do t'i përmbahen çdo akti provokues që mund të rrezikojë sigurinë dhe stabilitetin e rajonit.

**14 tetor:** Në Bruksel u mbajt raundi i dytë i negociatave ku Beogradi shpjegoi më tej propozimin për autonomi brenda Serbisë, ndërsa Prishtina propozimin e saj për miqësi dhe bashkëpunim midis dy shteteve të pavarura dhe respektimin e plotë të të drejtave të pakicave.

**22 tetor:** Në raundin e tretë të bisedimeve në Vjenë, delegacioni i Beogradit paraqiti propozimin e tij mbi 14 parimet për rifillimin e negociatave, duke deklaruar se çështja e statusit duhet të jetë tema mbizotëruese në dialogun e mëtejshëm. Këto bisedime u vlerësuan si shumë të rënda. Ndërkohë, „Trojka“ ndërmjetësuese i dorëzoi të dy palëve dokumentin e saj me 14 pika ku përmenden pikat e mundshme prekëse në bazë të të cilave Beogradi dhe Prishtina mund të bien dakord. Të dy delegacionet dhanë komentet e tyre për atë dokument.

**5 nëntor:** Në raundin e katërt të negociatave në Vjenë, ekipi negociues i Beogradit, i kryesuar nga Presidenti dhe Kryeministri i Serbisë, sugjeroi që në kontekstin e statusit të ardhshëm të Kosovës të merret në konsideratë modeli i Hong Kongut, gjë që e refuzoi ekipi i Prishtinës.

**20 nëntor:** Në raundin e pestë të negociatave në Bruksel, ekipi i Beogradit plotësoi propozimin e vet të autonomisë së gjerë të Kosovës, sipas modelit të Hong Kongut me elemente që lidhen me pozitën e Ishujve Aland në Finlandë, dhe që një zgjidhje e tillë të bëhet për 20 vjetë. Delegacioni i Prishtinës prezantoi vizionin e tij të pavarësisë së mbikqyrrur të Kosovës në përputhje me rekomandimet e Marti Ahtisarit.

**28 nëntor:** Negociatat përfundimtare pa sukses. Ekipi i Prishtinës njoftoi se pavarësia e Kosovës do të shpallet së shpejti dhe refuzoi mundësinë e vazhdimit të negociatave. Beogradi njoftoi se nuk pranon pavarësinë e Kosovës dhe shprehu gatishmërinë për të vazhduar negociatat pas 10 dhjetorit.

**10 dhjetor:** U përfundua periudha prej 120 ditëve të negociatave shpesh midis Beogradit dhe Prishtinës dhe u prezantua raporti i "Trojkës" ndërmjetësuese, përkatësisht Grupit të Kontaktit për Kosovën. Raporti i përfaqësuesve të BE-së, SHBA-së dhe Ruisë Wolfgang Ishinger, Frenk Vizner dhe Aleksandar Bocan-Harchenko iu dorëzua disa ditë më parë Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së Ban Ki-Munit. "Trojka" theskoi në raport se Beogradi dhe Prishtina nuk arritën marrëveshje mbi statusin e ardhshëm të Kosovës, por negociatat ishin të dobishme dhe dy palët paraqitën propozimet e tyre. Raporti gjithashtu vë në dukje se të dy palët u angazhuan për përmbajtje nga dhuna.<sup>76</sup>

## “Kosova për atlete”

### 2008.

**17 janar:** Këshilli i Sigurimit të KB-së mbajti në Nju Jork mbledhjen në të cilën është shqyrtuar raporti i UNMIK-ut për situatën në Kosovë, ndërsa ambasadorëve të vendeve anëtare iu drejtua presidenti i Serbisë, Boris Tadiq. Tadiq në pjesën e parë të hapur të mbledhjes, i bëri thirrje Këshillit të Sigurimit të KB-së që të marrë vendimin për vazhdimin e bisedimeve për statusin e ardhshëm të Kosovës e Metohisë, dhe shprehu gadishmërinë e Serbisë që të vazhdojë menjëherë këto bisedime me qëllim të gjetjes së zgjidhjes "me kompromis dhe të qëndrueshme".

**22 janar:** Kuvendi parlamentar i Këshillit evropian miratoi rezolutën për zhvillim në procesin e zgjidhjes së statusit të Kosovës, pa bërë thirrje për vendosjen e zgjidhjeve siç u kërkua në fillim. Rezoluta u miratua me 96 vota pro, 48 deputetë ishin kundër ndërsa 24 të përmbajtur. Projekt-rezolutën e paraqiti Lordi Russell Johnston, raportuesi i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Kosovën.

**1 shkurt:** Ambasadorët e 27 vendeve anëtare të Bashkimit europian në Bruksel miratuan modalitetet juridike dhe financiare të misionit për Kosovën që do të përbëhet nga 1.800 ekspertë juridikë dhe policor.

**14 shkurt:** Në selinë e KB-së në Nju Jork me kërkesë të Serbisë u mbajt mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit të Sigurimit për Kosovën, në të cilën foli Vuk Jeremiç, si dhe ambasadorët e anëtarëve të Këshillit.

**16 shkurt:** Bashkimi europian dha dritën e gjelbër për dërgimin e misionit të vetë EULEKS në Kosovë duke u mbështetur në burimet diplomatike në Bruksel. BE lejoi dërgimin e rreth 2.000 pjesëtarëve të EULEKS-it në Kosovë, që duhet të zëvendësojnë misionin e deritëhershëm të Kombeve të bashkuara.

**17 shkurt:** Kuvendi i Kosovës miraton deklaratën për pavarësinë. Reagimet e para nga bota erdhën brenda të njëjtës ditë, më 17 shkurt. Zëdhënësi i Stejt departmentit, Shon Makormak, tha se SHBA-ja „morrën dijeni“ për këtë vendim të Kuvendit të Kosovës, ndërsa Rusia e dënoi ashpër këtë vendim të njëanshëm dhe thirri urgjentisht mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të KB-së. Mbledhja e Këshillit të Sigurimit të KB-së u mbajt më 17 shkurt në orën 15 sipas orës lokale. Ambasadori i Rusisë pranë KB-së Vitalij Çurkin-tha se Rusia do të këmbëngulë për respektimin e Rezolutës së KB-së 1244, sipas të cilës garantohet integriteti territorial i Serbisë. Pas debatit dy orësh, në të cilin Rusia përkrahu kërkesën e Serbisë që Këshilli i Sigurimit të vërtetojë integritetin territorial dhe sovranitetin e Serbisë, mbledhja përfundoi pa marrje rezolute për shkak të qëndrimeve të ndryshme diametrale të Kinës e Rusisë nga njëra anë, dhe SHBA-së dhe shumicës së shteteve të Bashkimit europian nga ana tjetër. Vendi i parë që njohu zyrtarisht pavarësinë e Kosovës ishte Kostarika, që e bëri këtë gjë që në 17 shkurt, dhe pastaj edhe Avganistani. Pastaj, të nesërmen më 18 shkurt të 2008-ës, zyrtarisht e njohën edhe SHBA-ja, -Franca, -Mbretëria e Bashkuar, Shqipëria dhe-Turqia. -Pas deklaratës së-Kondoliza Rajsit, kryeministri i Serbisë, -Vojislav Koshtunica, njoftoi për tërheqjen e ambasadorit nga SHBA-ja.

**18 shkurt - 21 shkurt:** Pas lajmit për shpalljen e pavarësisë së Kosovës, nga 17 shkurti nisi seria e incidenteve nëpër rrugët e Serbisë, më shumë në Beograd. Në natën ndërmjet 17/18 shkurtit në Terazije dhe Sllavija u çmontuan restorantet Mekdonalds, grupet e huliganëve kanë sulmuar policinë, është hedhur edhe gazi lotsjellës. U thyen dritaret në selinë e PLD-së, dhe është sulmuar shtëpia në të cilën jeton kryetari i PLD-së, Çedomir Jovanović.<sup>77</sup> Të njëjtën natë janë sulmuar edhe ekipet e gazetarëve të B92, Studio B, FoNet-it, RTL-së kroate, Palma plus dhe RTS-së. U lënduan të paktën 35 persona, polica dhe civilë. Policia nga ajo natë filloi të ruajë me forca më të mëdha policore ndërtesat e qeverisë dhe disa ambasada<sup>78</sup>. Për shkak të pranimin të pavarësisë së Kosovës nga ana e Sllovenisë, u sulmuan qendrat tregtare Merkator në Çaçak, Novi Sad dhe Beograd, ndërsa market tregtare sllovene, si në periudhën 1990-1991, u bojkotuan.

Mitingu „Kosova është Serbi“ u mbajt më 21 shkurt të vitit 2008 në sheshin para Shtëpisë së Kuvendit Popullor në Beograd, organizuar nga Qeveria e Serbisë, si shprehje kundërshtimi për shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës. Pas kësaj, u mbajt lutje para Tempullit të Shën Savës, që e shërbeu peshkopi malazezo-bregdetar Amfilohije. Në lutje morrën pjesë Kryeministri i Serbisë Vojislav Koshtunica, Zëvendës Kryetari i PRS-së dhe Kryetari i PSS-së Tomisllav Nikoliq e Ivica Daçiq, numër i madh ministrash të Qeverisë së Serbisë, si dhe Kryeministri i Republikës Srpska Milorad Dodik. Sipas vlerësimeve të mediave, protesti mbledhi disa qindra mijë njerëz. Ministria e Arsimit vendosi që nëpër shkollë, në Serbi, të shpallej ditë pushimi, dhe ishte organizuar edhe transporti falas për në Beograd për ata që donin të merrnin pjesë në miting. Pas lutjes, një grup rreth 200 demonstruesve u veçua dhe sulmoi ndërtesat e ambasadave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë, Turqisë dhe Kroacisë, si dhe dy restorante Mekdonalds dhe disa lokale në Terazije. Demonstruesit dogjën edhe flamujt e këtyre shteteve, dhe më shumë u dëmtua ambasada e SHBA-së, e cila u dogj dhe shkatërrua plotësisht. Një nga demonstruesit, Zoran Vujović nga Novi Sadi, u gjet i vdekur në ndërtesën e ambasadës. Rezultatet e autopsisë treguan se u mbyt me tym. Policia atë natë arrestoi 192 persona. Gjatë rrëmujës u lënduan 130 persona.

Seanca e parë kundër 15 personave të akuzuar për djegjen (vetëm) të ambasadës së SHBA-së dhe Turqisë është mbajtur në prill të vitit 2013 por

<sup>77</sup> Letra e PLD-së organeve shtetërore dhe opinionit publik, Sajti i PLD-së (20.2.2008.): <http://bit.ly/2fahDLA>;

<sup>78</sup> Seria e incidenteve në Beograd, B92 (18.02.2008.): <http://bit.ly/2jw0NeY>;

dy vjetë nuk pati asnjë seancë, derisa në mars të vitit 2015 nuk u ndryshua aktpadia.<sup>79</sup> Në shtator të vitit 2015 Gjykata e Lartë merr aktvendimin e shkallës së parë që, për sjellje të dhunshme, të dënojë 9 prej 15 të akuzuarve me dënimet e kushtëzuara me burg për djegjen e ambasadës së SHBA-së, me zgjatje nga pesë deri në dhjetë muaj, me afatin e verifikimet prej dy, përkatësisht tre vjetësh, ndërsa dy të akuzuar janë liruar.<sup>80</sup>

Në fillim të dhjetorit të vitit 2016 gjykata e Apelit në Beograd anuloi aktvendimin e shkallës së parë për djegjen e ambasadës së Amerikës dhe Turqisë në vitin 2008 pas mitingut "Kosova është Serbia" dhe dha urdhër që gjyqi të përsëritet. Megjithatë, gjykata ia vërtetoi aktvendimin Drazhenko Nikoliqit i cili për shkak të sjelljes së dhunshme është dënuar me dënimin e kushtëzuar me pesë muaj burg, me afat verifikimi prej dy vjetësh. Me të njëjtin vendim, është vërtetuar aktvendimi i liruës për Aleksandar Erceci dhe Dushan Sedlar.<sup>81</sup>

Pas pothuajse 10 vjetësh, pas rrëmujës masive, më 11 korrik të viti 2017 Prokuroria e Lartë Publike ngriti aktpadinë kundër 5 funksionerëve të lartë të policisë, sepse me mosndalimin e djegjes së ambasadës "kanë shkaktuar rrezikun për jetën dhe trupat e njerëzve dhe pronën me përmasa të gjera".<sup>82</sup>

**26 shkurt:** Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Qeverisë së Serbisë u morr vendimi që kundër shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës të bëhet kundërshtimi me mjete juridike dhe diplomatike.

**8 tetor:** U miratua Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të KB-së 63/3 prej 8 tetorit të 2008-ës (me iniciativë të Serbisë) me të cilën është kërkuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë që të japë mendimin këshillues lidhur me këtë pyetje: A është shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës prej institucioneve të përkohshëm të vetëqeverisjes në Kosovë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare?"

## **2010.**

**22 korrik:** Mendimi këshillues i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë nga 22. korriku 2010 për çështjen e legalitetit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Kryetari i kësaj gjykate, japonezi Hisashi Owada lajmëroi se Deklarata për shpalljen e njëanshme të pavarësisë së Kosovës nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, Rezolutën 1244 dhe as me Kornizën e përkohshme kushtetutore në Kosovë.<sup>83</sup>

**9 shtator:** Asambleja e përgjithshme e KB-së miratoi Rezolutën për Kosovën që e dorëzoi Serbia duke përshtatur versionin e mëparshëm me Bashkimin evropian. Në bazë të kësaj rezolute është vendosur korniza për bisedimet e reja midis Serbisë dhe Kosovës për çështjet e pazgjidhura që do t'i ndërmjetësojë BE-ja.<sup>84</sup>

## **2011.**

**12 dhjetor:** Lubisha Dikoviq është vendosur Kryeshef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Serbisë. Në raportin "Dosjeja Dikoviq",<sup>85</sup> Fondi për të drejtën humanitare vërtetoi se Dikoviq si komandant i Brigadës së 37-të të motorizuar të Ushtrisë së Jugosllavisë, ka ditur (është dashur të dijë) se "shkatërrimi i FTSH (forcave terroriste shqiptare)" bëhet me granatimin e fshatrave, persekutimin e popullit, plaçkitje, përdhunime dhe vrasje të paligjshme të civilëve shqiptarë. Krimet janë përsëritur, nga njëri aksion në tjetrin, për „shturrjen dhe shkatërrimin e FTSH-së“. FDH gjithashtu nga fillimi i janarit të vitit 2015 nxorri „Dosjenë Rudnica“<sup>86</sup> ku gjenden të dhënat për lidhjen e Dikoviqit dhe njësisë nën komandën e tij me 52 viktima të zhvarrosura që janë gjetur në varrin masiv Rudnica. Në shkurt të të njëjtit vit, presidenti i Serbisë, Tomislav Nikoliq e dekoroi Dikoviqin me dekoratën e Shqiponjës së bardhë me shpata të shkallës së parë.

79 Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut, Zbatimi i standardeve të gjyqimit të drejtë në sistemin gjyqësor të Serbisë (2015): Çështja e djegjes së ambasadave në Beograd në vitin 2008, faq. 111-115: <http://bit.ly/1H8iN5I>;

80 Proteste masive në Beograd përsëri pa dënimin adekuat, Njoftimi i Nismës së të rinjve për të drejtat e njeriut (09.09.2015.): <http://bit.ly/2y5BeE9>;

81 U anuluan dënimet e kushtëzuara djemëve që dogjiën ambasadën e SHBA-së, Blic (05.12.2016.): <http://bit.ly/2jyYq3X>;

82 Të akuzuar zyrtarë të Policisë, kush është përgjegjës për dëshimet?, N1 Info (12.07.2017.): <http://bit.ly/2xpmbia>;

83 Pjesë nga Mendimi Këshillëdhënës i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (22.07.2010.), Peščanik: <http://bit.ly/2xb4FH3>;

84 Rezoluta e pajtuar është kthesë në marrëdhëniet e ardhshme, RSE (9. 09.2010.): <http://bit.ly/2xHii99>;

85 Dosjeja Dikoviq, FDH (2012.): <http://bit.ly/2xwAtab>;

86 Dosjeja Rudnica, FDH (2015.): <http://bit.ly/1RJHw2K>;

## Negociatat teknike (Tahiri - Stefanoviq)

2011.

Negociatat e reja ndërmjet Serbisë dhe përfaqësuesve të shqiptarëve të Kosovës filluan më datën 8 mars të vitit 2011. me BE-në si ndërmjetësuese dhe me përkrahjen e plotë të KB-së. Ndërmjet çështjeve kryesore palët vunë bisedimin për bashkëpunimin rajonal, përkatësisht për prezentimin rajonal, lëvizjen e lirë dhe mbizotërimin e të drejtës. Rrethi i parë ka përfshirë diskutimin për telekomunikacionet, mobilitetin dhe regjistrin civil dhe çështjet e CEFTA-s.

Republika e Kosovës shpalli pavarësinë më datën 17 shkurt të vitit 2008, dhe ky veprim është pranuar pjesërisht në nivelin ndërkombëtar.<sup>87</sup> Serbia këtë çështje ia dërgoi Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për mendimin e tyre këshillues. Me aktvendim është vërtetuar se nuk ka qënë e paligjshme për Kosovën që shpalli pavarësinë. Pas aktvendimit, Serbia dhe Bashkimi Europian i dërguan rezultatat Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara që kërkoi bisedimet teknike ndërmjet qeverive në Beograd dhe Prishtinë. Rezoluta e Serbisë dhe BE-së është miratuar në Asamblenë e përgjithshme të KB-së. Bisedimet u shtynë për shkak të rënies së qeverisë kosovare dhe zgjedhjeve të parakohshme në Kosovë.

Pas shpalljes së pavarësisë, mbikqyrje nga ana e bashkësisë ndërkombëtare ka patur institucioni i ashtuquajtur „Zyra ndërkombëtare“. Ajo zyrë ka përfunduar mandatin e vetë në shtator të vitit 2012, edhe pse egzistojnë disa forma të përkrahjes ndërkombëtare tranzitës së Kosovës, duke përfshirë EULEX-in dhe UNMIK-un.

Bisedimet janë bërë në Bruksel, ndërsa ndërmjetësues ishte Bashkimi Europian që e ka përfaqësuar Robert Kuper. Borko Stefanoviq ka udhëhequr grupin e negociatave nga Beogradi, ndërsa Edita Tahiri ekipin e negociatave nga Prishtina.



RAUNDET	DATA E TAKIMIT	PËRMBAJTA E BISEDIMEVE
I	8-9. mars i vitit 2011	Raundi i parë përfshinte bashkëpunimin ekonomik mes të dy palëve. Çështje të tjera në axhendë gjatë raundit të parë të dialogut ishin telekomunikacioni, trafiku ajror, vulat doganore, çështja e kadastrës dhe arkivat.
II	28. mars i vitit 2011	Çështjet e diskutuara gjatë raundit të dytë të bisedimeve ishin rryma, si dhe liria e lëvizjes, si dhe përfundimi i temave nga raundi i parë, si vula e Doganës së Kosovës, trafiku ajror dhe pjesëmarrja e Kosovës në iniciativat rajonale. Më 28 mars, përfaqësuesit e të dy palëve diskutuan për regjistrat e tokave dhe të lindjes, vdekjes dhe martesave, si dhe çështjet e furnizimit me energji elektrike. Stefanoviq tha se "është arritur përparim i caktuar në regjistrat e tokës, regjistrat e amzës dhe furnizimin me energji elektrike, ne kemi ngritur propozimin tonë dhe shpresojmë se më në fund do të jetë një fund pozitiv për këto tema në takimin e ardhshëm".
III	15. prill i vitit 2011	U diskutua për lirinë e lëvizjes, targat e regjistrimit për automjetet dhe njohjen e diplomave.
IV	17-18. maj i vitit 2011	Marrëveshja u arrit pothuajse në lidhje me çështjen e kadastrës dhe lirinë e lëvizjes; Bashkimi Europian ka propozuar gjithashtu zgjidhjen e çështjes së të të humburve dhe trashëgimisë kulturore.
V	2. qershor i vitit 2011	Raundi i pestë ishte planifikuar për 14 dhe 15 qershor të vitit 2011, por u shty disa ditë më parë. Supozohej se do të mbahej në fund të qershorit, por u mbajt më 2 korrik 2011. Pritej që të bëhej zgjidhja për kadastrë, lirinë e lëvizjes dhe çështjen e regjistrave, përkatësisht librave amzë. U arrit një marrëveshje mbi lirinë e lëvizjes përtej kufijve (individëve dhe makinave), për shkëmbimin e informacioneve për librat amzë në Serbi për të ndihmuar Kosovën në krijimin e regjistrat të vet amzë dhe për njohjen e diplomave të arsimit të njëjës apo palës tjetër.
VI	2. shtator i vitit 2011 (Ndërmjet këtyre dy raundeve u bë kriza për shkak të djegjes së kalimeve kufitare dhe vrasjes së policit kosovar Enver Zumberit.)	Raundi i gjashtë duhej të zhvillohej më 20 dhe 21 korrik të vitit 2011. Negociatat u shtynë deri në shtator një ditë më parë, për shkak se përfaqësuesi i Kosovës donte të shfaqeshin simbolet shtetërore në Kosovë, të cilat përfaqësuesi serb refuzoi. Më vonë u caktuan për 2 shtator 2011. Është arritur një marrëveshje për çështjen doganore (vula do të përmbajë vetëm fjalët "Dogana e Kosovës") dhe në kadastrë; duke folur për telekomunikacionin dhe arsimin e lartë, nuk u arrit asnjë marrëveshje për këto çështje.
VII	28. shtator i vitit 2011	Raundi i shtatë ishte planifikuar për në 28 shtator 2011. Delegacioni serb refuzoi të vazhdojë bisedimet, derisa policia e Kosovës dhe zyrtarët e doganave kontrollojnë operacionet kufitare, të cilat nuk ishin rënë dakord më parë dhe rezultuan me dhunë.

## Rezultatet e negociatave të vitit 2011:

- Përfaqësuesit e Serbisë dhe Kosovës ranë dakord për lëvizjen e lirë përtej kufirit (administrativ), si për njerëzit ashtu edhe për automjetet;<sup>88</sup>
- Beogradi ra dakord që t'i japë Prishtinës kopjot e kadastrës dhe dokumentat për lindjet, vdekjet dhe martesat në Kosovë;<sup>89</sup>
- Njohja reciproke e diplomave universitare të Serbisë dhe Kosovës (marrëveshja parimore është arritur me konkluzionin e vitit 2015;<sup>90</sup>
- Beogradi ra dakord që të pranojë pullat doganore të Kosovës që shënojnë "Doganën e Kosovës";<sup>91</sup> Kjo marrëveshje gjithashtu çoi drejt fundit të embargos tregtare dhe mundësoi tregtinë ndërmjet dy entiteteve.

88 Marrëveshja për lëvizjen e lirë (2.07.2011.): <http://bit.ly/2gX5qdw>;

89 Marrëveshja e arritur për librat amzë 2.07.2011: <http://bit.ly/2xgmFjI>;

90 Marrëveshja për njohjen e diplomave: <http://bit.ly/2wVthDU>;

91 Marrëveshja për vulën e doganave: <http://bit.ly/2wVHLSA>;

- Kalimet e integruara kufitare në veri të Kosovës;<sup>92</sup>
- Përfaqshmeria e autoriteteve në Prishtinë në organizatat rajonale;<sup>93</sup>
- Oficerët ndërlidhës të shkëmbyer ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe të stacionuar në misionet e BE-së;<sup>94</sup>

## Dialogu i Brukselit

### 2012 - 2017.

Shumë shpejt pas djegjes së kalimeve kufitare (1 e 31, Jarinje e Brnjak), përkatësisht të përleshjeve të qytetarëve me kombësi serbe me policinë kosovare, në Beograd, në gusht të vitit 2011 erdhi kancelarja gjermane Angela Merkel. Pas vizitës së saj, në tavolinë mbeten tre kërkesa të Gjermanisë me qëllim që Serbia deri në fund të vitit të marrë statusin e kandidatit: që të arrihen rezultate konkrete pas ripërtëritjes së dialogut me Prishtinën, që misionit juridik dhe civil të BE-së në Kosovë (Eulex) t'i mundësohet që "të punojnë siç duhet" dhe që të hiqen strukturat paralele shtetërore serbe në Kosovë.

Kundrejt kushteve për statusin e kandidatit por edhe nevojës që të zgjidhet konflikti, në pritje të zgjedhjeve pasardhëse parlamentare dhe presidenciale, Boris Tadiq, në janar të vitit 2012 del me planin e ri, përkatësisht me 4 pika që i quajti vija të kuqe të politikës ndaj Kosovës:

- Zgjidhja për Veriun e Kosovës, që e karakterizon realiteti ndryshe nga dominimi i shqiptarëve në jug
- Mbrojtja e manastireve dhe trashëgimisë kulturore në Kosovë
- Mbrojtja e pronës së shtetit dhe qytetarëve në Kosovë
- Garanci të veçanta për sigurinë dhe të ardhmen e serbëve nëpër enklava

Pas ndryshimit të pushtetit në Beograd (në fillim presidenti i shtetit bëhet Tomislav Nikoliq më 20 maj të vitit 2012) përkatësisht nga formimi i Qeverisë së re më 27 korrik të vitit 2012 në krye me Ivica Daçiq dhe nënkryetarin e parë Aleksandar Vuçiq, vazhdon dialogu.

Më 19 tetor 2012, bisedimet për normalizimin përmes Bashkimit Europian vazhdojnë me Kryeministrin e Serbisë Ivica Daçiq dhe me kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçi. Arritja e një marrëveshjeje të re më themelore ishte një kusht i domosdoshëm për kandidaturën e Serbisë për në BE. Qeveritë kanë arritur ngadalë marrëveshje dhe kanë trajtuar fusha të ndryshme, që kanë qënë çështje e negociatave edhe gjatë vitit 2011, si liria e lëvizjes, diplomat universitare, përfaqësimi rajonal dhe tregtia, dhe doganat ndërkombëtare.

Pas marrëveshjes së dhjetorit 2012, të dy palët shkëmbyen oficerët ndërlidhës që kanë punuar në dy zyra të BE-së në dy kryeqytetet. Prishtina i quajti këta përfaqësues "ambasadorë", por Beogradi e refuzoi një emërim të tillë.

Në Bruksel, Serbia dhe Kosova ranë dakord se zbatimi i marrëveshjes kufitare do të fillojë më 10 dhjetor 2012. Takimi historik u mbajt më 6 shkurt të vitit 2013, kur Presidenti i Serbisë, Tomislav Nikoliq dhe Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, për herë të parë që nga shpallja e pavarësisë, u ulën në të njëjtën tryezë.

Marrëveshja e re çoi Serbinë në negociatat për pranimit në BE, ndërsa Kosovën drejt siglimit të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim (MSA). MSA-në e nënshkruan Federica Mogherini dhe Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, në tetor të vitit 2015, ndërsa Serbia hapi bisedimet e para-pranimit me BE-në në janar 2014.

Zyrtarët shtetërorë të Serbisë u takuan me Përfaqësuesen e Lartë të BE-së për Punë të Jashtme dhe Siguri Katherine Ashton në Bruksel më 11 mars

92 Marrëveshja për kontrollin e integruar të kufijve (IBM): <http://bit.ly/2jyUqS>;

93 Marrëveshja për prezentimin rajonal: <http://bit.ly/2xrB0U>;

94 Sajti i Zyrës për Kosovën e Metohinë i Qeverisë së Republikës së Serbisë: <http://bit.ly/2jipqvF>;

të vitit 2013, ndërsa Presidenti i Serbisë Nikoliq tha se Serbia dhe Kosova janë shumë afër nënshkrimit të një marrëveshje që do të përmirësonte marrëdhëniet e tyre reciproke.

Më datën 19 prill të vitit 2013, të dy qeveritë kanë përfunduar tekstin e Marrëveshjes me titull "Marrëveshja e Parë për parimet e rregullimit të normalizimit të marrëdhënieve" ose Marrëveshja e Brukselit, e cila u mirëprit si një hap i madh drejt normalizimit të marrëdhënieve, gjë që i mundësoi Serbisë dhe Kosovës përparimin në integrimin evropian. Të dy vendet janë zotuar të mos "bllokojnë ose inkurajojnë të tjerët të bllokojnë përparimin e palës tjetër në rrugët e dhura të BE-së".

Ndërmjet masave të tjera, me marrëveshje është vendosur komandanti i posaçëm i policisë (komandantin e emëron Prishtina nga lista e qytetarëve të kombësisë serbe) dhe gjykata ankimore (me ligjin dhe procedurat në korniza të sistemit juridik të Kosovës) për pakicën serbe në Kosovë. Marrëveshja ka parashikuar ndërtimin e Asociatës së Komunave me shumicë serbe, që ishte argumenti më i madh i Beogradit për mbrojtjen e serbëve në Kosovë, si dhe integrimin e plotë të të gjitha strukturave të sigurisë nga policia deri te pjesët e pashpërndara të sigurisë shtetërore në Kosovë.

Gjithashtu, një dispozitë e rëndësishme e marrëveshjes është pjesëmarrja e pakicës serbe në zgjedhjet lokale, të cilat do të shpallen më vonë për në dhjetor të vitit 2013 me kontrollimin e misionit të OSBE-së. Marrëveshja gjithashtu parashikonte tema për të cilat do të diskutohet (telekomunikacionet dhe energjia), si dhe një plan për zbatimin e Marrëveshjes.<sup>95</sup> Pas këtyre zgjedhjeve, faktor i pashmangshëm për formimin e çdo qeverie të ardhshme do të jetë "Lista Srpska", një parti e serbëve të Kosovës, e cila ka lidhje të ngushta me Beogradin zyrtar. Marrëveshja u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës, më 28 korrik të vitit 2013.

- Teksti i Marrëveshjes për doganën nga 17 janari 2013<sup>96</sup>;
- Teksti i tërë marrëveshjes nga 19 prilli i vitit 2013;<sup>97</sup>
- Më datën 7 gusht të vitit 2013 dy qeveritë nënshkruajtën Marrëveshjen për vendosjen e kalimeve të përhershme kufitare ndërmjet Serbisë e Kosovës gjatë vitit 2014;<sup>98</sup>
- Më 8 shtator të vitit 2013 u nënshkruajt Marrëveshja e parë për energjetikën;<sup>99</sup>
- Një ditë më vonë, më 9 shtator të vitit 2013 është arritur Marrëveshja për telekomunikacionet që, ndërmjet të tjerash, i mundësoi Kosovës të dorëzojë kërkesën për numrin e vetë ndërkombëtar;<sup>100</sup>

Dy ditë më vonë, qeveria serbe njoftoi për shpërbërjen e kuvendeve të pakicave serbe të krijuara në Veriun e Kosovës për të lejuar integrimin e pakicës serbe në sistemin e Kosovës. Për të lehtësuar integrimin e pakicës serbe në veri në shoqërinë kosovare, parlamenti i Kosovës miratoi një ligj që fali veprimet e kaluara të rezistencës ndaj autoriteteve të Kosovës. Ky parim hyri në fuqi në fillim të dhjetorit të vitit 2013 pasi qeveritë e Serbisë dhe Kosovës ranë dakord për emërimin e anëtarit të pakicës serbe në vendin e shefit të policisë në veri të Kosovës. Të dy qeveritë kanë arritur gjithashtu një marrëveshje për lejimin e Kosovës për të aplikuar për numrin e saj ndërkombëtar të prefiksit kur qeveria serbe të fillojë negociatat për pranimin në BE.

95 Teksti i planit për implementim në dispozicion në faqen e portalit KOSSEV: <http://bit.ly/2wXx3Lb>;

96 Marrëveshja për doganën (17.01.2013.): <http://bit.ly/2jlyCQ9>;

97 Teksti i marrëveshjes së 19 prillit të vitit 2013 në dispozicion në faqen e portalit KOSSEV: <http://bit.ly/2fiplam>;

98 Teksti i marrëveshjes për vendosjen e kalimeve të përhershme kufitare: <http://bit.ly/2w5oReP>;

99 Teksti i marrëveshjes për energjetikën nga 8 shtatori i vitit 2013: <http://bit.ly/2xXnrIH>;

100 Teksti i marrëveshjes për telekomunikacionet nga 9 shtatori i vitit 2013: <http://bit.ly/2wWMDk1>;

## Konteksti lokal politik si pasojë e dialogut në Bruksel

Zgjedhjet lokale të Kosovës pas marrëveshjes së Brukselit u mbajtën më 3 nëntor dhe 1 dhjetor të vitit 2013, ishin të një rëndësie të veçantë pasi këto janë zgjedhjet e para të mbajtura ndonjëherë në të gjithë territorin e Kosovës, duke përfshirë katër komuna veriore me shumicë serbe të Mitrovicës Veriore, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok, në përputhje me ligjin e Kosovës.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Aleanca e Kosovës së Re vendosën kryetarët e komunave në dy komuna, ndërsa Iniciativa Qytetare për Malishevën ishte fituese në të njëjtën komunë. Partia Demokratike e Kosovës fitoi në komunat Prizren, Dragash, Klinë, Kamenicë, Rahovec dhe Vushtrri, ndërsa Lidhja Demokratike e Kosovës ishte fituese në komunat Gjilan, Lipjan, Pejë, Suharekë, Ferizaj dhe Viti. Aleanca e Kosovës së Re fitoi në komunat e Gjakovës dhe Mitrovicës, ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës mori kryetarët e komunave në Obiliq dhe Junik. Sipas rezultateve të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, nga shtatë komuna me shumicë serbe në Kosovë në gjashtë komuna fitoi Iniciativa Qytetare "Srpska" (IQS). Në zgjedhjet për kryetar të Mitrovicës së veriut, sipas këtyre rezultateve, fituesi ishte Krstimir Pantiq nga IQS i cili fitoi 55.20% të votave, ndërsa Oliver Ivanoviq fitoi 44.80% të votave.<sup>101</sup>

Edhe pse festoi fitoren në zgjedhjet e para lokale të mbajtura sipas sistemit të Kosovës në Mitrovicën e veriut, Krstimir Pantiq, më vonë nuk e mori detyrën, sepse më 13 janar të vitit 2014 refuzoi të nënshkruajë dokumentet mbi të cilat ishin simbolet e Republikës së Kosovës. Është e rëndësishme të kujtohet se Krstimir Pantiq ishte sulmuar nga sulmues të panjohur më 1 nëntor të vitit 2013, dy ditë para raundit të parë të zgjedhjeve. Pas refuzimit të Pantiqit për të marrë detyrën, si dhe të bashkëpunojë me Aleksandar Vulin, drejtorin e atëhershëm të Zyrës së Qeverisë së Serbisë për KeM, përsëriten zgjedhjet për kryebashkiakun e Mitrovicës së Veriut dhe caktohen për fundin e shkurtit të të njëjtit vit. Lista Qytetare "Srpska" kandidon Goran Rakiqin, dhe më 27 janar të njëjtin vit, kundërshtari, Oliver Ivanoviq iu përgjig thirrjes së Prokurorisë Speciale të Kosovës në lidhje me hetimin ndaj tij për krime lufte dhe mbetet në paraburgim. Ndërkohë, Rakiq mori 2.700 vota, ose 52.6 për qind, kandidati i Iniciativës Qytetare SDP Oliver Ivanoviq 1.420 vota, dhe kështu fitoi Lista Srpska.

Oliver Ivanoviqin Prokuroria e Kosovës e ngarkoi për krime kundër popullatës civile në Kosovë dhe Metohi të kryera në vitin 1999 dhe 2000. Aktakuza u ngrit në nëntor 2014 kundër Ivanoviqit dhe katër personave të tjerë të cilët u paraburgosën me të, të cilët në fillim të gjyqit kategorikisht i hodhën poshtë të gjitha të thënat në aktakuzë. Gjyqi filloi më 18 dhjetor të vitit 2014. Prokuroria propozoi një numër të madh dëshmitarësh, u renditën edhe emrat e viktimave dhe vendeve ku të akuzuarit gjoja kanë bërë krime të luftës. Aktakuza ndërmjet të tjerash thotë se Ivanoviq u ka dhënë urdhra formacioneve paraushtarake dhe udhëhoqi rojet e urës në Kosovska Mitrovica, dhe se me këtë rast ka mbajtur armë automatike, pistoletë dhe dy thika të mëdha.<sup>102</sup>

Për shkak të refuzimit për ta lënë të mbrohet i lirë, Oliver Ivanoviq, më 7 gusht 2015 filloi një grevë urie, ndërsa më 14 gusht për shkak të shëndetit të dobët u çua në spitalin e Mitrovicës. Më 21 janar të vitit 2016. trupi gjyqësor i EULEX-it i shprehu në Gjykatën Themelore në Kosovska Mitrovicë udhëheqësit të Iniciativës së Qytetarëve PSD Oliver Ivanoviq dënimin me nëntë vjet burg për krime lufte të kryera në vitin 1999 në atë qytet, kur u vra kur një grup i shqiptarëve. Në të njëjtën kohë, Ivanoviq u lirua për rastin e dytë të vrasjes dhe tentativës së vrasjes në vitin 2000. Të katër të pandehurit e tjerë serbë - ish kolonel i policisë i MPB-së së Serbisë Dragoljub Delibashiq, profesori Aleksandar Lazoviq, avokati Ilija Vujaçiq dhe avokati Nebojsa Vujaçiq u liruan nga paditë. Në shkurt të vitit 2017 Gjykata e Apelit në Prishtinë anuloi Aktvendimin e shkallës së parë dhe urdhëroi një gjykim të ri. Pastaj ishte në paraburgim shtëpiak, dhe nga viti 2017 është caktuar që të mbrohet nga liria. Gjatë fushatës për zgjedhjet lokale në Kosovë, i është djegur automjeti, dhe katër anëtarë të iniciativës së tij u tërhoqën nga fushata, për shkak të, siç thanë ata atëherë, frikësimit.<sup>103</sup>

Në zgjedhjet parlamentare të Kosovës më 8 qershor të vitit 2014, Lista Srpska fitoi 9 vende në parlament nga dhjetë vende për komunitetin serb, ndërsa një vend i takoi Partisë Progresive Demokratike. Pas një krize të madhe politike të institucioneve, qeveria e udhëhequr nga Isa Mustafa, u formua më 9 dhjetor të të njëjtit vit dhe zgjati deri në votimin e mosbesimit më 10 maj të vitit 2017.<sup>104</sup>

101 Ndryshimet në Kosovë, DW (2.12.2013.): <http://bit.ly/2DYXuWX>;

102 Rasti i Oliver Ivanoviqit, B92 (16.01.2018.): <http://bit.ly/2FtVu67>;

103 Njësoj: <http://bit.ly/2FtVu67>;

104 Kosovë: Janë shpallur rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, RSE (26.06.2014.): <http://bit.ly/2DNhnbwB>;

## Rasti „Dron“

Tetori 2014 mbahet mend për marrëdhëniet e tendosura midis Shqipërisë dhe Serbisë, si dhe në mes të serbëve dhe shqiptarëve në Serbi për shkak të rastit DRON i cili la pasoja edhe për procesin e bisedimeve në Bruksel. Acarimi u bë lidhur me incidentet që shënuan ndeshjen Serbi-Shqipëri që filloi më 14 tetor, por u ndërpre në gjysmën e dytë. Acarimet mund të vërehen në tre nivele. Në një nivel, në tetor është rritur në mënyrë drastike numri i raporteve të mediave të cilat inkurajuan urrejtjen dhe intolerancën ndaj shqiptarëve, si dhe mosbesimin ndaj anëtarëve të këtij grupi etnik dhe ndaj Shqipërisë. Këto mbishkrime ishin më të shumta në mediat tabloide, dhe u shoqëruan me një numër të madh komentesh fyese në portalet e internetit dhe në rrjetet sociale. Në nivelin e dytë, kishte acarim politik. Nga njëra anë, ky ishte acarim i marrëdhënieve midis dy vendeve, të dukshme në deklaratat ministrore dhe fjalët e zyrtarëve të lartë, si dhe në botimet e tyre në rrjetet sociale. Nga ana tjetër, acarimi u tregua edhe në reagimin e zyrtarëve të Serbisë për sulmet mbi objektet në pronësi të shqiptarëve në Serbi, i cili duhej të qe më i shpejtë dhe më i qartë në dënimin e tyre. Në nivelin e tretë, në Vojvodinë është bërë një sërë sulmesh mbi objektet në pronësi të shqiptarëve në të cilat është bërë dëm material, që në disa raste është totale, ndërsa në disa raste, me fat, është shmangur humbja e jetës. Po të mos ishte bërë acarimi në media dhe në nivelin politik, dmth, që mediat dhe zyrtarët të ishin sjellë me përgjegjësi, është e arsyeshme të supozojmë se nuk do të ndodhnin të paktën një numër sulmesh. Do të kishte më pak incidente, dhe në rastet e sulmeve më të hershme mbi pronën e zotëruar nga shqiptarët në Serbi, sulmuesit do të ndiqeshin penalisht dhe do dënoheshin.

Pas ndërprerjes së ndeshjes së futbollit të mbajtur më 14 tetor<sup>105</sup>, pasoi një numër i madh sulmesh ndaj objekteve të zotëruara kryesisht nga shqiptarët. Ndezja dhe prishja e objekteve ndodhi në disa qytete në Serbi, kryesisht në territorin e Vojvodinës, të cilën Iniciativa (Nisma) e dokumentoi në raportin e saj pasi kishte vizituar të njëjtat objekte. Edhe pse sipas atyre që ka shkruajtur VOICE, nga marsi i vitit 2016<sup>106</sup>, janë formuar 5 çështje nëpër prokuroritë për ndezjen e furrave anembanë Vojvodinës dhe është shprehur 1 masë edukative ndaj të miturit, 1 vepër penale është refuzuar askush prej 62 persona të identifikuar nga policia, si kryerës, nuk është ndjekur penalisht. Nuk janë zbuluar as autorët e sulmeve më të rënda - në Stara Pazova dhe Sombor, në të cilat jetët e njerëzve ishin të rrezikuara. Në kualifikimin e këtyre veprave penale, duhet të kihet parasysh se këto sulme nuk ishin drejtuar vetëm në pronën private apo në pronësinë e bashkësive fetare, por gjithashtu kishin ndikim serioz në marrëdhëniet ndëretnike në Serbi.<sup>107</sup>

Gjatë vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015, ka pasur një vonesë në negociata, kryesisht të shkaktuara nga fushatat zgjedhore në Serbi dhe Kosovë. Përkundër kësaj, më 10 mars të vitit 2015, u nënshkrua Marrëveshja për gjyqësorin midis Serbisë dhe Kosovës.<sup>108</sup>

Më shumë vështirësi pati në dhjetor të vitit 2014, pasi presidenti i Serbisë Tomislav Nikoliq doli kundër qëndrimit të Qeverisë, duke deklaruar se çdo vendim mbi Kosovën duhet të dorëzohet në një referendum duke lajmëruar për platformën e vetë për Kosovën. Progresi më i madh është arritur me nënshkrimin e marrëveshjes për mbrojtjen civile, përkatësisht integrimin e këtyre njësive në sistemin e Kosovës. Marrëveshja u nënshkrua më 26 mars të vitit 2015.<sup>109</sup>

Me aktorët e vjetër politik të cilët tani kanë marrë role të reja, më 26 gusht të vitit 2015, Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar një sërë marrëveshjesh në fushat kyçe dhe kanë bërë një hap të madh drejt normalizimit të lidhjeve që konsiderohet si marrëveshja numër dy në Bruksel. Ministri i jashtëm i Kosovës ka deklaruar se kjo është de facto njohje e pavarësisë, ndërsa kryeministri i Serbisë tha se ka siguruar përfaqësimin për serbët

105 Ndërkohë, më tetor të vitit 2014 mediat kanë shkruajtur se Ministri i Punëve të Brendshme Nebojsa Stefanoviq themeloi grupin e punës i cili është dashur të merrej me përgjegjësinë e policisë për mosndalimin e huliganëve në sjelljen e dhunshme atë natë me detyrë që të bëhej raporti për rasti e djegjes së ambasadës. Raporti nuk është shpallur kurrë dhe as e ka vërtetuar MPB-ja ekzistimin e grupit të punës.

106 Epilogu i djegjes së furrave një masë edukuese, VOICE (14.03.2016): <http://bit.ly/2fcBg9g>;

107 Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut, Zbatimi i standardeve të gjyqësorit të drejtë në sistemin e gjyqësorit të Serbisë (2015): Shqiptarët dhe Serbët: Raporte me rrezik të madh, faq. 54-71: <http://bit.ly/1H8iN5l>;

108 Tekst i marrëveshjes për gjyqësorin: <http://bit.ly/2f2rbM7>;

109 Tekst i marrëveshjes për integrimin e mbrojtjes civile: <http://bit.ly/2h174uE>;

etnikë në Kosovë. Tema kryesore e negociatave ishte Asociacioni i Komunave Serbe (AKS)<sup>110</sup> përkatësisht miratimi i Statutit të tij në kuadër të sistemit ligjor të Kosovës, me shtesa për energjinë, telekomunikacionin dhe lirinë e lëvizjes në urën në Ibër në Mitrovicë.

Si rezultat i marrëveshjes, Serbia ka përparuar zyrtarisht duke hapur kapituj shtesë në negociatat e saj të bashkimit me BE-në. Marko Djuriq, Shef i Zyrës së KeM të Serbisë, tha se Serbia fitoi 5:0.

Megjithatë, autoritetet serbe vazhdojnë të kundërshtojnë çdo iniciativë me të cilën qeveria e Kosovës do të bashkohet me agjencitë e KB-së dhe iniciativa e anëtarësimit të Kosovës në UNESCO haset vazhdimisht në fushatën negative të Serbisë. Gjatë vitit 2016, çështjet e disponueshmërisë të pronës së Trepçës dhe zbatimi i marrëveshjes për AKS, ishin pengesat më të mëdha për të dyja palët për të rënë dakord më tej. Pas një sërë protestash të opozitës në Prishtinë gjatë viteve 2015 dhe 2016, formimi i AKS-së dhe çështja e demarkacionit me Malin e Zi çojnë në paqëndrueshmërinë e punës së Kuvendit dhe qeverisë të udhëhequr nga Isa Mustafa. Prandaj, në fund të vitit 2015, Presidentja Atifete Jahjaga ia dërgon Marrëveshjen për AKS të nënshkruar në gusht të vitit 2015 Gjykatës Kushtetuese. Në dhjetor të të njëjtit vit, Gjykata Kushtetuese e Kosovës vendos që Marrëveshja për AKS-në nuk është plotësisht në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Megjithatë, në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, thuhet se Gjykata Kushtetuese ka vërtetuar "se Asociacioni / Komuniteti i Komunave me shumicë serbe do të themelohet, siç parashihet me Marrëveshjen e Parë, të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe të shpallur nga Presidentja e Republikës së Kosovës."<sup>111</sup>

Në janar të vitit 2017, treni i pikturuar me ngjyrat e flamurit serb dhe fjalët "Kosova është Serbi" u pengua të hyjë në Kosovë. Atë nga Beogradi e përcolli Marko Djuriq, shefi i zyrës së KeM, me këshilltarin e tij, Misha Vaciq, i cili mori pjesë në trazirat e muajit gusht dhe të vitit 2011 si anëtar i lëvizjes ekstreme të djathtë "Naši 1389" ("Tanët 1389"). Presidenti i Serbisë, Tomislav Nikoliq, tha se Serbia do të dërgojë ushtrinë e saj në Kosovë nëse sulmohen serbët. Qeveria e Kosovës e shihte trenin si një provokim. Kriza më e gjerë është penguar nga biseda telefonike e dy kryeministrave. Para kësaj, Serbia dhe Kosova mobilizuan forcat e tyre ushtarake (Serbi) dhe forcat e sigurisë (Kosovë) përgjatë kufirit kosovaro-serb, përkatësisht vijës administrative.

Ramush Haradinaj, Kryeministri aktual i Kosovës, u arrestua më 9 janar të vitit 2017 në Francë sipas urdhër arrestit të Republikës së Serbisë, gjë që shqetësoi akoma më tepër të dyja palët. Haradinaj u arrestua më 4 janar në aeroportin e Basel Mulhaus pranë kufirit me Zvicrën, në bazë të urdhërit të lëshuar nga Serbia përmes Interpolit pas tij që në vitin 2006, në lidhje me krimet kundër civilëve që i kanë bërë njësitë nën kontrollin e tij në "zonën e luftës Dukagjin" (Metohija) gjatë konflikteve të armatosura në Kosovë. Dy vjet më parë, në bazë të të njëjtit urdhër arresti, ai u arrestua në aeroportin në Lubjanë, por u lirua pas vetëm disa ditësh.

Arrestimi gëzoi Beogradin zyrtar dhe shkaktoi zemërim të përgjithshëm në Kosovë, por edhe në Shqipërinë fqinje. Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi menjëherë tha se akuzat kundër Haradinajt janë të një natyre politike dhe, duke kujtuar se Tribunali i Hagës e ka liruar dy herë, kërkoi nga Franca që ta lirojë menjëherë. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, menjëherë iu bashkua atij, i cili tha se arrestimi është "absurd" si dhe kryetari i kuvendit shqiptar, Ilir Meta, i cili deklaroi se "Haradinaj është hero dhe simbol i luftës së lirisë për të gjithë shqiptarët anëmbanë botës". Opozita e Kosovës paralajmëroi një seri protestash duke kërkuar që dialogu i Brukselit për normalizim me Beogradin të ndërpritet menjëherë, ndërsa para ambasadës franceze në Prishtinë janë bërë demonstrata me mesazhin "Kërkoni kriminelët në Serbi". Në Deçan, vendlindjen e Haradinajt, flamuri francez u dogj publikisht. Dhe sa filloi të ngrohej, u nis treni, dhe Haradinaj u zhdruk menjëherë nga radari.<sup>112</sup>

Provokim me qëllim, apo neglizhenca e Zyrës së Qeverisë së Serbisë për Kosovën dhe Metohinë, rasti i trenit të zburuar nga jashtë me mesazhe politike që u dërgua më 14 janar dhe nga brenda me piktura të trashëgimisë kulturore të Kosovës dhe Metohisë, kryesisht ikonat ortodokse nga manastiret e Kosovës, e sollën brenda një afati mjaft të shkurtër tërë rajonin deri në nxehje. Treni që kurrë nuk e përfundoi udhëtimin e tij të parë nga Beogradi në Mitrovicë të Kosovës solli Kosovën dhe Serbinë në prag të konfliktit, pavarësisht ishte i imagjinuar apo jo. Kriza përfundoi me një bisedë telefonike midis Vuçiq dhe Thaçit, ndërsa Ramush Haradinaj u lirua me vendimin e gjykatës në Kolmar më 27 prill të vitit 2017.<sup>113</sup>

110 Teksti i marrëveshjes për AKS: <http://bit.ly/2fADht8>;

111 Gjykata Kushtetuese e Kosovës: Marrëveshja për AKS nuk është plotësisht në përputhje me Kushtetutën por AKS-ja do të formohet, KOSSEV portali: <http://bit.ly/2jYepQm>;

112 Dejan Anastasijević, Telashtet me Ramushin, VREME nr. 1359, 19.01.2017: <http://bit.ly/2xHvoNd>;

113 Treni i pikturuar deri në Mitrovicë, N1/ Istineromer amnezia(1.6.2017): <http://bit.ly/2wjwY7w>;

## Gjykata speciale për krime të luftës në Kosovë

Nga 1 janari i 2017-ës në Kosovë është operative gjykata Speciale me seli në Hag, e ngarkuar që të shqyrtojë dyshimet për krimet e bëra ndaj civilëve serbë dhe të kombësive të tjera gjatë dhe pas luftës në Kosovë. Kjo gjykatë u formua pas zbulimit të ish Kryeprokurores së Tribunalit të Hagës Karla del Ponte, të botuar më vitin 2008 në memoaret-e saj (The Hunt: Me and the war criminals-/ Lov: Unë dhe kriminelët e luftës), se Prokuroria e Hagës ka gjasa për kidnapimet masive nga fundi i luftës dhe pas saj në Kosovë. Raportuesi special i Këshillit të Europës Dik Marti bëri hetimin që në fund të vitit 2010 rezultoi me raport<sup>114</sup>-me 27 faqe, ku thuhet se rreth 500 civilë (rreth 400 jo-shqiptarë, në shumicë serbë, por edhe romë, si dhe 100 shqiptarë) janë rrëmbyer në Kosovë pas shpërndarjes së forcave të KFOR-it dhe se një pjesë e tyre në fshehtësi është dërguar në Shqipëri për t'u bërë tregti me organet e tyre. Këshilli European e miratoi këtë raport nga fillimi i vitit 2011 dhe kërkoi „hetimin e pavarur që do të çonte drejt të vërtetës së plotë për këto të thëna“. Kjo nisi mekanizmin për formimin e gjykatës Speciale.

Pas shumë negociatash, është vendosur që të formohet gjykatë e veçantë që nominalisht do të jetë pjesë e sistemit të gjyqësorit të Kosovës, por vendosur jashtë Kosovës, dhe ku do të angazhohen vetëm gjykatës dhe prokuror ndërkombëtarë. Selia e kësaj gjykate është në Hagë, në kryeqytetin gjyqësor ndërkombëtar, paratë për punën e saj i ka siguruar Bashkimi European, por atë, në veçanti në pjesën e prokurorisë e drejton SHBA-ja. Nga miratimi i raportit të Martit në Kuvendin parlamentar të Këshillit European deri në formimin e Gjykatës Speciale për Kosovën kaluan 6 vjetë. Vlerësohet se ajo do të punojë rreth 8 vjetë duke përfshirë edhe procesin ankimor. Në raportin e vetë Dik Marti si më të përgjegjshmit për krime me të cilët do të merret gjykata Speciale, emëron direkt udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), në krye me Hashim Thaçin, që kanë qënë anëtarë të të ashtuquajturit grup të Drenicës, dhe të cilët sot janë shtylla kurrizore e establishmentit politik në Kosovë.<sup>115</sup>

114 Raporti i Dik Martit, zyrtarit raportues të Këshillit European (12.12.2010.): <http://bit.ly/2hhvXT7>;

115 Ismet Hajdari, Llogaritja e re e kohës për drejtësinë në Kosovë, Hajnrih Bel fondacioni (29.12.2016.): <http://bit.ly/2jlc2Bo>;

# Në vend të konkluzionit

Pas pauzës së gjatë në negociata, dhe pas zgjedhjes së Aleksandar Vuçiqit president të Serbisë, më 3 korrik dhe 31 gusht, takohen dy presidentët dhe jo kryeministrat siç ka ndodhur deri atëherë. Thaçi dhe Vuçiq thanë se dialogu do të vazhdojë me një tempo më dinamike. Më datën 31 gusht, pas takimit të përbashkët, ranë dakord për realizimin e marrëveshjes së nënshkruajtur për gjyqësorin për 17 tetorin e këtij viti. Paralelisht me këtë, janë bërë negociatat për qeverinë e re të Kosovës, që më në fund u formua më 9 shtator dhe në krye të së cilës është Ramush Haradinaj para koalicionit PDK (Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për ardhmërinë e Kosovës - AAK dhe Iniciativa për Kosovën - NISMA) me përkrahjen e Bëxhet Pacollit dhe Listës Srpska. Në intervistën e tij të parë si kryeministër i Kosovës, Haradinaj përmend, si Aleksandar Vuçiq, "domosdoshmërinë e dialogut të brendshëm, në veçanti me serbët e Kosovës".<sup>116</sup> Është e rëndësishme të përmendet se koalicioni në pushtet ishte i pamundur pa hyrjen e listës Srpska në Qeverinë e Kosovës.

Megjithatë, domosdoshmëria për të hyrë në dialog të brendshëm kërkon nxjerrjen e fakteve dhe ndërmarrjen e përgjegjësive. Në rastin e Serbisë harrohet shpesh lidhja e integriteteve europiane dhe çështja e Kosovës si dhe korniza e vendosur strategjike ku Serbia mund të zbatojë politikë të caktuar me qëllim të zgjidhjes së çështjeve të diskutueshme me Kosovën. Një kornizë e tillë gjendet në kornizën e negociatave të Bashkimit Europian për Serbinë nga 9 janari i vitit 2014.<sup>117</sup>, si dhe në tekstin e pozicionit të përbashkët të BE-së ndaj Serbisë për kapitullin 35,<sup>118</sup> të nënshkruajtur më 30 nëntor të vitit 2015. Njohuria për të ditur se në cilin pozicion jemi si shoqëri ndaj Kosovës, dhe ndërmarrja e përgjegjësive për politikën e gabuar gjatë disa dekadave të kaluara, janë hapat e parë drejt dialogut të vonuar, por të domosdoshëm të brendshëm për Kosovën.

116 Edhe Haradinaj propozon dialogun e brendshëm - në Kosovë, Blic (11.09.2017.): <http://bit.ly/2h7NhgX>;

117 Korniza negociuese e Bashkimit Europian për Serbinë, 9 janar 2014. godine: <http://bit.ly/2wgxc1k>;

118 Teksti i pozicionit të përbashkët të BE për kapitullin 35 (nëntor 2015.): <http://bit.ly/2w5AClf>;



## TABELA E MARRËVESHJEVE NGA DIALOGU I BRUKSELIT (2011-2017)<sup>119</sup>

DATA	TEMA E MARRËVESHJES	LINK
2.7.2011.	Marrëveshja për lëvizjen e lirë	<a href="http://bit.ly/2gX5qdw">http://bit.ly/2gX5qdw</a>
2.7.2011.	Marrëveshja për librat amzë	<a href="http://bit.ly/2xgmFjl">http://bit.ly/2xgmFjl</a>
21.11.2011.	Marrëveshja për njohjen e diplomave	<a href="http://bit.ly/2wVthDU">http://bit.ly/2wVthDU</a>
2.9.2011.	Marrëveshja për vulën e doganave	<a href="http://bit.ly/2wVHLSA">http://bit.ly/2wVHLSA</a>
2.9.2011.	Marrëveshja për kadastrën	<a href="http://bit.ly/2xiuiEA">http://bit.ly/2xiuiEA</a>
2.10.2011.	Marrëveshja për kontrollin e integruar të kufijve	<a href="http://bit.ly/2jyUqS">http://bit.ly/2jyUqS</a>
24.2.2012.	Marrëveshja për prezentimin dhe bashkëpunimin rajonal	<a href="http://bit.ly/2xrB0ul">http://bit.ly/2xrB0ul</a>
9.1.2013	Marrëveshja për procedurat për ndihmën juridike ndërmjet palëve	<a href="http://bit.ly/2heP4Re">http://bit.ly/2heP4Re</a>
17.1.2013.	Marrëveshja për doganën	<a href="http://bit.ly/2jlyCQ9">http://bit.ly/2jlyCQ9</a>
19.4.2013.	Marrëveshja e parë për parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve („Marrëveshja e Brukselit“)	<a href="http://bit.ly/2ydn581">http://bit.ly/2ydn581</a>
19.4.2013.	Plani për implementimin e marrëveshjes së parë për normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës	<a href="http://bit.ly/2h1rfjh">http://bit.ly/2h1rfjh</a>
7.8.2013.	Marrëveshja për vendosjen e kalimeve të përhershme kufitare	<a href="http://bit.ly/2w5oReP">http://bit.ly/2w5oReP</a>
8.9.2013.	Marrëveshja për energjetikën	<a href="http://bit.ly/2xXnrIH">http://bit.ly/2xXnrIH</a>
9.9.2013.	Marrëveshja për telekomunikacionet	<a href="http://bit.ly/2wWmdk1">http://bit.ly/2wWmdk1</a>

DATA	TEMA E MARRËVESHJES	LINK
13.12.2013.	Marrëveshjet e dhomave tregtare	<a href="http://bit.ly/2hhFolz">http://bit.ly/2hhFolz</a>
14.11.2014.	Marrëveshja për vizitat zyrtare	<a href="http://bit.ly/2wGjdv7">http://bit.ly/2wGjdv7</a>
10.02.2015.	Marrëveshja për gjyqësorin	<a href="http://bit.ly/2faejA6">http://bit.ly/2faejA6</a>
26.03.2015.	Marrëveshja për integrimin e mbrojtjes civile	<a href="http://bit.ly/2h174uE">http://bit.ly/2h174uE</a>
26.05.2015.	Marrëveshja për njohjen reciproke të sigurimit të automjeteve	<a href="http://bit.ly/2wydCvr">http://bit.ly/2wydCvr</a>
25.08.2015.	Marrëveshja për Asocienin e komunave serbe (AKS)	<a href="http://bit.ly/2fAMMbL">http://bit.ly/2fAMMbL</a>
25.08.2015.	Marrëveshja e dytë për energjetik	<a href="http://bit.ly/2ydB6CG">http://bit.ly/2ydB6CG</a>
26.08.2015.	Plani i veprimtimit për telekomunikacionet	<a href="http://bit.ly/2faPELN">http://bit.ly/2faPELN</a>
26.08.2015.	Konkluzionet e grupit të punës për lëvizjen e lirë në Urën në Ibër	<a href="http://bit.ly/2jjKLhK">http://bit.ly/2jjKLhK</a>
29.9.2015.	Konkluzionet për njohjen reciproke të diplomave	<a href="http://bit.ly/2wVthDU">http://bit.ly/2wVthDU</a>
30.11.2015.	Pozita negociuese e BE-së në negociatat me Serbinë për Kapitullin 35	<a href="http://bit.ly/2w5AClf">http://bit.ly/2w5AClf</a>
14.9.2016.	Rënia dakord lidhur me finalizimin e zbatimit të Marrëveshjes për lëvizjen e lirë nga viti 2011.	<a href="http://bit.ly/2jj3IkF">http://bit.ly/2jj3IkF</a>
13.11.2016.	Konkluzionet e ndërmjetësuesit të BE-së lidhur me telekomunikacionet	<a href="http://kim.gov.rs/p23.php">http://kim.gov.rs/p23.php</a>
30.11.2016.	Konkluzionet e ndërmjetësuesit të BE-së për gjyqësorin	<a href="http://bit.ly/2xdWfzB">http://bit.ly/2xdWfzB</a>

<sup>119</sup> Kronologjia e marrëveshjeve e marrë nga tre burime:

KOSSEV portali: <http://bit.ly/2h1rfjh>;

Sajti i Zyrës për Kosovën e Metohinë: <http://bit.ly/2faejA6>;

Sajti i Qeverisë së Serbisë: <http://bit.ly/2hi0iku>;

Autor: Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut  
Gjeorgjia e Uashingtonit 26 / III / 16, Beograd  
Redaktor: Marko Milosavljevic  
Përkthyer në anglisht: Teodora Zaharijević,  
Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut  
Përkthyer në shqip: Eda Radoman  
Dizajni dhe paraqitja: Nemanja Manjenčić

Publikimi "Kronologjia e Kosovës (1974-2017)" u mbështet në kuadër të projektit "Dialogu i hapur, përfshirës dhe pjesëmarrës mbi Kosovën dhe ndryshimet kushtetuese" nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur, Serbi.

Mars 2018.